



Një analizë e Sistemit të Mbrotjtjes Sociale në Shqipëri

Mbulimi, shpenzimet, mjaftueshmëria dhe financimi



▶ **Një analizë e Sistemit të Mbrojtjes Sociale në Shqipëri**

Mbulimi, shpenzimet, mjaftueshmëria dhe financimi

Copyright © Organizata Ndërkombëtare e Punës 2021

Botimi i parë 2021

Botimet e Organizatës Ndërkombëtare të Punës gëzojnë të drejtën e autorit sipas Protokollit 2 të Konventës Universale të së Drejtës së Autorit. Megjithatë, pjesë të shkurtra nga to mund të riprodhohen pa autorizim, me kusht që të tregohet burimi. Për të drejtën e riprodhimit ose përkthimit, aplikimi duhet të bëhet tek Byroja e Botimeve të ILO-s (Të Drejtat dhe Lejet), International Labour Office, CH -1211 Geneva 22, Switzerland, ose nëpërmjet postës elektronike: rights@ilo.org. Zyra Ndërkombëtare e Punës mirëpret aplikime të tilla.

Bibliotekat, institucionet dhe përdoruesit e tjerë të regjistruar në organizata që kanë të drejta riprodhimi, mund të bëjnë fotokopje në pajtim me licencën lëshuar atyre për këtë qëllim. Vizitoni www.ifrro.org për të gjetur organizatën me të drejta riprodhimi në vendin tuaj.

ILO.2021. Një Analizë e Sistemit të Mbrojtjes Sociale në Shqipëri: mbulimi, shpenzimet, mjaftueshmëria dhe financimi; Ekipi i Mbështetjes Teknike për Punën e Denjë në ILO dhe Zyra Qëndrore për Europën Lindore dhe Qëndrore (DWT/CO-Budapest).-Budapest: ILO 2021

ISBN 9789220347577 (Print)

ISBN 9789220347584 (web PDF)

Also available in English:

Review of social protection system in Albania: coverage, expenditure, adequacy and financing.

ISBN 9789220347607 (Web PDF)

Ekipi i Mbështetjes Teknike për Punën e Denjë në ILO dhe Zyra Qëndrore për Europën Lindore dhe Qëndrore

Dizenjot në Botimet e ILO-s, të cilat janë në përputhje me praktikat e Kombeve të Bashkuara, dhe paraqitja e materialit aty nuk nënkupton shprehjen e ndonjë opinioni të cfarëdolloji nga Zyra Ndërkombëtare e Punës në lidhje me statusin ligjor të ndonjë vendi, rajoni a territori ose të autoriteteve të tyre, ose në lidhje me përcaktimin e kufijve të tyre.

Përgjegjësia për opinionet e shprehura në artikujt, studimet dhe kontributet e nënshkruara është vetëm e autoreve, dhe botimi nuk përbën miratimin e Zyrës Ndërkombëtare të Punës për opinionet e shprehura aty.

Referenca për emra kompanish, produkte dhe procesesh tregtare nuk nënkupton njohjen e tyre nga Zyra Ndërkombëtare e Punës, dhe çdo mospërmendje e ndonjë kompanie të veçantë, produkti ose procesi tregtar, nuk është shenjë e mosaprovimit.

Për më shumë informacione për publikimet e ILO apo ato dixhitale, vizitoni faqen tonë në internet: www.ilo.org/publns

Foto e Kopertinës © iStock by Getty Images

Ky dokument u përgatit nga ILO në kuadër të Programit të Përbashkët të Kombeve të Bashkuara, për "Përshpejtimin e Mbrojtjes Sociale në Nivel Vendor" (IMSPSD), zbatuar nga Qeveria Shqiptare në bashkëpunim me agjensitë e Kombeve të Bashkuara: UNDP, UNICEF, UN Women dhe WHO, gjithashtu edhe me pjesëmarrjen e UNFPA dhe ILO dhe i financuar nga Fondi i SDG. Ky Program mbështet Qeverinë Shqiptare të përkthejë politikat në veprime konkrete në nivel lokal me qëllim që meshkujt, femrat, vajzat dhe djemtë që jetojnë në varfëri ose në situata vulnerable të kenë akses në shërbime cilësore dhe të integruara të kujdesit social dhe që mbështesin vizionin e gjithëpërfshirjes sociale në Shqipëri.

▶ Përmbajtja

Lista e tableve dhe figurave	v
▶ Hyrje	vii
▶ 1. Konteksti i vëndit	1
1.1. Situata socio-ekonomike dhe tregut të punës	1
1.2. Ndryshimet demografike dhe perspektiva e moshimit të popullsisë	2
1.3. Varfëria dhe pabarazia në të ardhura	3
▶ 2. Përshkrimi i sistemit të mbrojtjes sociale të Shqipërisë	7
2.1. Kuadri ligjor dhe institucional	7
2.2. Dispozita për përfitime nga skema kontributive	10
2.3. Dispozita për përfitime nga programe jo kontributive	12
▶ 3. Shpenzime për mbrojtjen sociale dhe mjaftueshmëria e përfitimit	19
3.1. Shpenzimet për mbrojtjen sociale	19
3.2. Mbulimi me përfitime dhe mjaftueshmëria e përfitimeve	21
3.3. Reduktimi i varfërisë me përfitimet e mbrojtjes sociale	28
▶ 4. Çështjet aktuale në sistemin e mbrojtjes sociale në Shqipëri	31
4.1. Mbulimi i kontribuesve nga skemat e sigurimeve sociale dhe shëndetësore	31
4.2. Statusi financiar i Fondit të Sigurimeve Shoqërore dhe Fondit të Sigurimeve Shëndetësore	37
4.3. Reformat e ndihmës ekonomike dhe shërbimeve të kujdesit social	40
▶ 5. Ndikimi i COVID-19 : një vlerësim paraprak	45
▶ 6. Konkluzion	49
▶ Referenca	53
▶ Aneksi. Mbrojtja sociale dhe vendet e punës në reagim ndaj COVID-19	55

► Lista e tabelave dhe figurave

Tabelat

Tabela 1.1.	Indikatorët kryesorë ekonomike dhe të tregut të punës, 2010-2019	1
Tabela 1.2.	Indikatorët kryesorë demografikë 1990-2050	2
Tabela 1.3.	Indikatorët e varfërisë nga Anketa e Matjes së Standartit të Jetesës, 2002-2012	4
Tabela 1.4.	Indikatorët e varfërisë nga Anketa për Kushtet e Jetesës, 2017-2018	4
Tabela 1.5.	Niveli i rrezikut të rënies në varfëri sipas grup moshave dhe gjinisë, 2017-2018	5
Tabela 2.1.	Kuadri institucional i shërbimeve të ndihmës ekonomike dhe kujdesit social	9
Tabela 2.2.	Kushtet e ligjshme për pensionet e të moshuarve	10
Tabela 2.3.	Hapat për përcaktimin e të drejtës për përfitim nga ndihma ekonomike	14
Tabela 3.1.	Shpenzimet e mbrojtjes sociale në Shqipëri të vlerësuara sipas përfitimeve, 2010-2017 (si një % ndaj PBB)	19
Tabela 3.2.	Shpenzimet për mbrojtjen sociale në disa vënde, 2017 (si një % ndaj PBB)	20
Tabela 3.3.	Shpenzimet shëndetësore sipas burimit të financimit në vëndet e përzgjedhura, 2016-2017	20
Tabela 3.4.	Numri i pensionistëve sipas tipeve dhe skemave urban/rural, 2011 - 2019	21
Tabela 3.5.	Numri i pensionistëve sipas gjinisë, tipit dhe skemave urbane/rurale, 2011-2019	22
Tabela 3.6.	Pensionet mesatare mujore sipas tipit dhe skemës urbane/rurale, 2012-2019	23
Tabela 3.7.	Numri i përfituesve të pagesave afat - shkurtër, 2012-2019	24
Tabela 3.8.	Numri i përfituesve dhe masa mujore e pagesës së papunësisë, 2010-2019	25
Tabela 3.9.	Numri i përfituesve dhe përfitimi mesatar i ndihmës ekonomike sipas numrit të anëtarëve në familje, 2010-2019	26
Tabela 3.10.	Numri i përfituesve të pagesës së paaftësisë sipas llojit, 2015-2020 (ne fillim te vitit)	27
Tabela 3.11.	Efektet e transfertave sociale në reduktimin e varfërisë, 2017-2018	29
Tabela 4.1.	Mbulimi kontributiv i vlerësuar i popullsisë në moshë pune, 2019	32
Tabela 4.2.	Përmbledhje e statistikave të shëndetësisë, 2017-2018	34
Tabela 4.3.	Të ardhurat dhe shpenzimet e Fondit të Sigurimeve Shoqërore (përfitimet detyruese) 2011-2019 (në milion lekë)	35
Tabela 4.4.	Të ardhurat dhe shpenzimet e Fondit të Sigurimeve Shoqërore (përfitimet detyruese), 2011 - 2019. (në milion lekë)	38
Tabela 4.5.	Të ardhurat dhe shpenzimet e Fondit të Sigurimit Shëndetësor, 2011-2018 (në milion lekë)	39
Tabela 5.1.	Parashikimi i FMN për indikatorët kryesorë makroekonomikë, Shqipëria, 2019-2025	45
Tabela 5.2.	Parashikimi ekonomik i Komisionit European, Shqipëria, 2019-2022	46
Tabela 5.3.	Reagimet e mbrojtjes sociale dhe vendeve të punës ndaj COVID-19, Tremujori dytë i 2020	47

Figurat

Figura 3.1.	Raporti i rrezikut të rënies në varfëri, 2018	29
Figura 3.2.	Efektet e transfertave sociale në reduktimin e varfërisë, 2017–2018	30
Figura 4.1.	Mbulimi i sigurimeve shoqërore sipas statusit në tregun e punës, 2019	33
Figura 4.2.	Statusi i tregut të punës sipas seksit dhe moshës, 2019	33
Figura 4.3.	Shpërndarja e pagave kontribuese për Institutin e Sigurimeve Shoqërore, 2017–2019	37
Figura 4.4.	Shpërndarja e pagave kontribuese për Institutin e Sigurimeve Shoqërore, 2017–2019	39

Hyrje

Kombet e Bashkuara në Shqipëri kanë zbatuar një Program të Përbashkët “Përshpejtimin e Mbrojtjes Sociale në Nivel vendor” për periudhën nga 1 Janari 2020 deri në 31 Janar 2022. Programi i Përbashkët synon të mbështesë pronësinë në nivel të pushtetit vendor për kushtet e shërbimeve të mbrojtjes sociale dhe për të rritur koordinimin ndërmjet shërbimeve shtetërore për mbrojtjen sociale dhe autoriteteve vendore, me fokus në përshpejtimin e qenësishëm në cilësinë dhe sasinë e shpërndarjes së integruar të kujdesit social në nivel komune si pjesë e një sistemi efektiv të integruar të mbrojtjes sociale.

Brenda kuadrit të Programit të Përbashkët të Kombeve të Bashkuara “Përmirësimi i Ofrimit të Shërbimeve Lokale të Mbrojtjes Sociale”, ILO në bashkëpunim me UNICEF dhe UNWOMEN, ka kryer një rishikim të sistemit të mbrojtjes sociale në Shqipëri me një këndvështrim për të identifikuar hapësirat në mbulim dhe financim të sistemit ekzistues, dhe analizimin e hapësirës fiskale për të ndërtuar një sistem bashkëkohor të mbrojtjes sociale që përfshin dyshemetë kombëtare të mbrojtjes sociale.

Raporti aktual do të sigurojë një përshkrim të sistemeve aktuale të mbrojtjes sociale, si kontribuese ashtu edhe jo-kontribuese, dhe të vlerësojë tendencat dhe performancat më të fundit në përputhje me strukturën dhe nivelet e shpenzimeve sociale, mbulimit të përfituesve dhe mjaftueshmërinë, mbulimin kontribues dhe qëndrueshmërinë financiare. Duhet të theksohet që shumica e të dhënave statistikore dhe ekonomike ishin të mundshme për periudhën deri në 2019. Duke qenë se raporti fokusohet në çështje strukturore afatgjata në sistemin aktual të mbrojtjes sociale, gjetjet dhe konkluzionet kryesore të këtij raporti mbeten të vlefshme pavarësisht pandemisë aktuale të COVID-19. Megjithatë, për të siguruar përditësim të mbrojtjes sociale në përgjigje të krizës së COVID -19, do të përfshihet edhe një analizë shtesë.

Ky raport u përgatit nga Kenichi Hirose, Specialist për Mbrojtjen Sociale, Ekipi i Mbështetjes Teknike për Punën e Denjë në ILO dhe Zyra Vendore për Europën Lindore dhe Qëndrore dhe Veronika Wodsak, Specialiste për politikën e Mbrojtjes Sociale, Departamenti i Mbrojtjes Sociale ILO.

Një mision i përbashkët i ILO u realizua në Shkurt 2020 për të ndërtuar një mekanizëm koordinimi ndërmjet projektit të ILO dhe UNICEF Shqipëri sikurse edhe stafit kryesor të angazhuar në punën për mbrojtjen sociale dhe çështjet fiskale në nivel kombëtar dhe atë lokal, dhe për të organizuar mbledhjen e informacioneve dhe të dhënave të domosdoshme për rishqyrtimin e sistemit aktual të mbrojtjes sociale dhe analizat për hapësirat fiskale.

Një draft i mëparshëm i këtij raporti u prezantua në Workshopin Tripalësh të Validimit i cili u mbajt në 27 Prill 2021, ku çështjet kryesore dhe politikën për të ardhmen u diskutuan nga partnerët trepalësh të ardhur nga qeveria dhe nga organizatat e punëdhënësve dhe të punëmarrësve. Përveç tyre, Alketa Zazo nga UNICEF Shqipëri dhe Ivona Paunovic e UNWOMEN Shqipëri siguruan komente mbi një version më të hershëm të këtij projekt raporti. Të gjitha komentet e përfuara nga partnerët e projektit dhe agjensive partnere të Kombeve të Bashkuara janë reflektuar në këtë raport final.

Projekti dhe raporti përfituan në mënyrë të jashtëzakonshme nga ndihma e Zhuljeta Harasanit, Koordinatorja Kombëtare e ILO për Shqipërinë, sikurse edhe nga Anisia Mandro dhe Fjoralba Balla, asistentet e projektit të cilat dhanë ndihmë në redaktimin e finalizimin e këtij raporti. Mbledhja e të dhënave statistikore u drejtua nga Klea Ibrahim. Një studim mbështetës i përgatitur nga Mirela Muça kontribuoi gjithashtu në raport.

Ky raport është i organizuar si vijon. **Kapitulli 1** prezanton situatën aktuale ekonomike dhe demografike në Shqipëri. **Kapitulli 2** përmbledh strukturën ekzistuese legale dhe institucionale të sistemit të mbrojtjes sociale në Shqipëri dhe dispozitat e tyre përfituese. **Kapitulli 3** prezanton shpenzimet qeveritare për mbrojtjen sociale, analizon mbulimin dhe nivelin e përfitimit, dhe vlerëson impaktin e përfitimeve në

uljen e varfërisë. **Kapitulli 4** analizon hendekun në mbulimin e sistemit të kontributeve dhe implikimet në efektivitetin e sistemeve, me një vëmendje të veçantë mbi përhapjen e punësimit informal dhe punës së padeklaruar, dhe në shfaqjen e formave jo-standarte të punësimit në Shqipëri. Ky kapitull shqyrton gjithashtu situatat financiare të Fondit të Sigurimeve Shoqërore dhe Fondit të Sigurimeve Shëndetësore dhe diskuton qëndrueshmërinë e tyre financiare. **Kapitulli 5** prezanton një vlerësim paraprak të ndikimit dhe masave të mbrojtjes sociale në kontekstin e pandemisë së COVID-19. **Kapitulli 6** konkludon me një përmbledhje të gjetjeve kryesore dhe rekomandimeve për drejtimet politike në të ardhmen.

Ne besojmë që ky shqyrtim do të informojë aktorët kryesorë në Shqipëri mbi sfidat aktuale dhe në të ardhmen për shërbimet e kujdesit social dhe të mbrojtjes sociale, dhe që rekomandimet e nxjerra nga ky shqyrtim do të kontribuojnë në dialogun kombëtar për të formësuar politikat në të ardhmen në mënyrë që të rritet efektiviteti i mbrojtjes sociale dhe shërbimeve të kujdesit social për të mos lënë askënd prapa.

1. Konteksti i vendit

► 1.1. Situata socio-ekonomike dhe e tregut të punës

Tabela 1.1 prezanton indikatorë të përzgjedhur ekonomikë dhe të tregut të punës të Shqipërisë nga 2010 në 2019. Gjatë kësaj periudhe, popullsia e Shqipërisë ka qenë pothuajse konstante në rreth 2.9 milion ndërkohë që shikohet një tendencë e vogël rënie.

► **Table 1.1. Treguesit kryesorë ekonomikë dhe tregut të punës, 2010–2019**

	Njësia	2010	2011	2012	2013	2014	2015	2016	2017	2018	2019	
A	Popullsia total	Mijëra	2,913	2,905	2,900	2,895	2,889	2,881	2,876	2,873	2,866	2,854
B	Popullsia (15 vjeç e lartë)	Mijëra	2,271	2,291	2,309	2,321	2,332	2,341	2,349	2,359	2,366	2,368
C	Popullsia ekonomikisht aktive*	Mijëra	1,357	1,349	1,317	1,217	1,257	1,311	1,365	1,385	1,403	1,420
D	Popullsia e punësuar	Mijëra	1,167	1,160	1,140	1,024	1,037	1,087	1,157	1,195	1,231	1,255
	• Të punësuar	Mijëra	505	453	418	415	431	446	477	527	548	578
	• Vetë-punësuar	Mijëra	354	345	307	264	270	317	404	428	418	403
	• Anëtarë kontribues të familjeve	Mijëra	308	364	415	366	336	324	277	240	266	274
E	Të papunë	Mijëra	190	189	176	194	220	224	207	190	173	165
F	Niveli i pjesëmarrjes së forcës së punës (C/B)	Përqindje	55.2	60.3	57.3	52.4	53.7	55.7	57.5	58.3	59.4	60.4
G	Niveli i papunësisë (E/C)	Përqindje	14.0	14.0	13.4	15.9	17.5	17.1	15.2	13.7	12.3	11.5
H	Niveli i papunësisë afatgjatë	Përqindje	10.5	10.3	10.3	11.5	11.2	11.3	10.1	8.9	8.3	7.3
I	Niveli i papunësisë (15-29 vjeç)	Përqindje	30.5	23.9	29.8	31.4	39.0	39.8	36.5	31.9	28.3	27.2
J	Niveli i papunësisë afat-gjatë (15-29 vjeç)	Përqindje	10.2	13.9	19.8	18.9	21.1	21.0	19.0	15.0	13.9	11.7
K	Niveli i inaktivitetit (15-29 vjeç)	Përqindje	66.3	55.2	63.3	72.4	71.0	68.7	68.2	68.2	64.2	63.3
L	PBB për frymë i korrigjuar me PPP	Dollarë	4,055	4,438	4,248	4,411	4,579	3,953	4,124	4,533	5,284	5,562
M	PBB për frymë me çmimet korrente	Dollarë	10,973	11,283	11,462	11,598	11,828	12,126	12,548	13,037	13,601	13,962
N	Niveli i rritjes reale të PBB	Përqindje	3.71	2.55	1.42	1.00	1.77	2.22	3.31	3.82	4.07	2.24

Burimi: Instituti i Statistikave të Shqipërisë.

Shënim: *Përfshin popullsinë 65 vjeç dhe sipër.

Niveli i papunësisë ka qenë në mënyrë të përhershme me dy shifra përgjatë dekadës së fundit, megjithëse ka rënë nga 17.5 përqind në 11.5 përqind në 2019. Pjesa e papunësisë afat-gjatë, po ashtu ka rënë së fundmi. Megjithatë, niveli i papunësisë ndërmjet të rinjve (15 dhe 29 vjeç) është dukshëm më i lartë në 27.2 përqind në 2019.

Rritja ekonomike ka qenë e njëjtë nga 2011 deri në 2015 pas krizës ekonomike globale. Vetëm pas vitit 2016 ekonomia e Shqipërisë u kthye në një shteg modest rritje me nivele reale të rritjes ndërmjet 3 dhe 4 përqind në vit. PBB për frymë, i korrigjuar me Paritetin e Fuqisë Blerëse (PPP), është ekuivalent me 13,961 Dollarë amerikanë në 2019, çka është 31.3 përqind e mesatares së 28 vëndeve të BE-së.

Ekonomia e Shqipërisë shfaq një shkallë të lartë të informalitetit. Një numër studimesh vlerësojnë që ekonomia informale në Shqipëri përbën 30 deri në 50 përqind të PBB. Problemi i informalitetit do të shqyrtohet në kontekstin e mbulimit të sigurimit social.

► 1.2. Ndryshimet demografike dhe perspektivat e moshimit të popullsisë

Tabela 1.2 prezanton indikatorët kryesorë demografikë nga 1990 deri në 2050 të bazuara në vlerësimet dhe projeksionet e Kombeve të Bashkuara.¹ Që nga 1990, ka pasur një rënie të shpejtë dhe të fortë të nivelit të fertilitetit total nga 3.2 fëmijë për grua në 1990 në 1.6 në vitin 2010, dyfishuar me përmirësim konstant në jetëgjatësinë për të dyja seksjet. Për më tepër, që nga mesi i 1990 ka pasur një fluks të rëndësishëm të largimit migrator i cili ka vazhduar si i tillë deri në ditët e sotme.

Në 1990, popullsia e Shqipërisë shpalosi një zgjerim tipik të strukturës moshore në të cilën pjesa e të moshuarve ishte vetëm 5.5 përqind. Për shkak të efekteve të tranzicionit të popullsisë, popullsia aktuale e Shqipërisë është akoma relativisht e re krahasuar me vendet fqinje. Megjithatë, ndryshimet demografike të sipërpërmendura do të shpien drejt një moshimi të shpejtë të popullsisë në të ardhmen. Sipas projeksioneve të Kombeve të Bashkuara, pjesa e të moshuarve pritet të rritet nga 14.7 përqind në 2020 në 25.5 përqind në 2050.

► Tabela 1.2. Indikatorët kryesorë demografikë 1990 - 2050

Popullsia	1950	1970	1990	2000	2005	2010	2015	2020	2030	2050
Popullsia totale (mijëra)	1,263	2,151	3,286	3,129	3,087	2,948	2,891	2,878	2,787	2,424
Mosha mesatare (vitet)	21.2	19.6	24.0	27.0	29.1	32.2	34.9	36.4	40.7	50.0
Popullsia nën 15 vjeç (mijëra)	485	880	1,077	949	818	662	540	496	445	293
Popullsia 15-64 vjeç (mijëra)	691	1,160	2,028	1,959	2,006	1,972	1,986	1,959	1,765	1,515
Popullsia 65+ vjeç (mijëra)	87	112	181	221	262	314	365	423	578	617
Përqindja e popullsisë nën moshën 15 vjeç	38.4%	40.9%	32.8%	30.3%	26.5%	22.5%	18.7%	17.2%	16.0%	12.1%
Përqindja e popullsisë së moshës 15-64 vjeç	54.7%	53.9%	61.7%	62.6%	65.0%	66.9%	68.7%	68.1%	63.3%	62.5%
Përqindja e popullsisë 65+ vjeç	6.9%	5.2%	5.5%	7.1%	8.5%	10.7%	12.6%	14.7%	20.7%	25.5%

¹ Mospërputhje të vogla gjenden ndërmjet Tabelës 1 dhe 2 për shkak të burimit të të dhënave.

Popullsia	1950	1970	1990	2000	2005	2010	2015	2020	2030	2050
Raporti i varësisë së fëmijëve	70.2%	75.9%	53.1%	48.4%	40.8%	33.6%	27.2%	25.3%	25.2%	19.3%
Raporti varësisë së moshave të vjetra	12.6%	9.7%	8.9%	11.3%	13.1%	15.9%	18.4%	21.6%	32.7%	40.7%
Raporti i varësisë në total	82.8%	85.5%	62.0%	59.7%	53.8%	49.5%	45.6%	46.9%	58.0%	60.1%

Niveli i ndryshimit të popullsisë	1950–1955	1965–1970	1985–1990	1995–2000	2000–2005	2005–2010	2020–2015	2015–2020	2025–2030	2045–2050
Niveli vjetor i ndryshimit të popullsisë (përqindje)	2.3%	2.5%	2.0%	0.1%	-0.3%	-0.9%	-0.4%	-0.1%	-0.4%	-0.9%
Raporti i lindjeve për 1000 banorë	39.5	33.7	26.0	18.7	14.5	11.9	12.4	11.8	9.6	7.8
Raporti i vdekjeve për 1,000 banorë	16.1	8.5	5.8	6.2	5.8	6.7	7.0	7.8	9.5	13.4
Raporti migrimit neto (për 1,000)	0.0	0.0	0.0	-11.5	-11.4	-14.4	-9.4	-4.9	-3.9	-3.2

Jetëgjatësia në lindje (vitet)	55.3	66.2	72.0	73.0	74.8	75.6	77.5	78.4	79.7	82.6
Jetëgjatësia në lindje për meshkujt (vitet)	54.4	65.1	69.3	70.2	72.3	73.2	75.2	76.7	78.3	81.5
Jetëgjatësia në lindje për femrat (vitet)	56.1	67.4	75.0	76.1	77.8	78.5	80.0	80.1	81.1	83.8
Jetëgjatësia pritshme në moshë 65 (vitet)	14.0	15.0	15.2	15.1	16.0	16.0	17.3	17.7	18.5	20.4
Raporti total i fertilitetit (lindje të gjalla për grua)	6.2	5.3	3.2	2.4	2.0	1.6	1.7	1.6	1.5	1.5

Burimi: Kombet e Bashkuar. Perspektiva e Popullsisë Botërore, i rishikuar. <https://population.un.org/wpp/>.

Në 1990, popullsia e Shqipërisë ekspozonte një strukturë tipike moshore ekspansive me një pjesë të të moshuarve vetëm me 5.5%. Për shkak të efekteve të momentit të popullsisë në tranzicion, popullsia aktuale e Shqipërisë është akoma relativisht e re krahasuar me vendet fqinje. Megjithatë, ndryshimet demografike të sipër përmendura pritet të çojnë në një moshim të shpejtë të popullsisë në të ardhmen. Parashikohet që pjesa e të moshuarve do të rritet nga 14.7 përqind në 2020 në 25.5 përqind në 2050.

► 1.3. Varfëria dhe pabarazia në të ardhura

Megjithëse Shqipëria nuk ka aprovuar një vijë zyrtare për varfërinë, një reduktim efektiv i varfërisë ka qenë prioritet i axhendës kombëtare. Duhet të shënohet, megjithatë, që matja e varfërisë në Shqipëri nuk ka qenë konsistente në periudha kohe të ndryshme për shkak të ndryshimeve të fundit në përkufizimin e varfërisë.

Tabela 1.3 prezanton indikatorët kryesorë të varfërisë sipas Anketimit të Matjes së Standarteve të Jetesës, të zhvilluar në 2002, 2005, 2008 dhe 2012. Në këtë anketim, një person në varfëri absolute është përcaktuar si një nga ata të cilët konsumi mujor për frymë është nën 4,891 lekë me çmimet e 2002 (ekuivalent me 43.3 Dollarë amerikanë), dhe një person në varfëri ekstreme përcaktohej si një nga ata persona që hasnin vështirësi në plotësimin e nevojave bazë të ushqimit (2,288 kalori në ditë). Në terma monetare,

linja e varfërisë ekstreme u ndërtua në nivelin e 3,047 lekë në muaj me çmimet e 2002 (ekuivalent me 27 Dollarë amerikanë).

Niveli i varfërisë absolute u ul nga 25.4 përqind në 2002 në 12.5 përqind në 2008 por u rrit në 14.3 përqind në 2012. Ajo vlerësoi që 415,000 persona jetonin në varfëri absolute në 2012. Niveli i varfërisë ekstreme u ul nga 5.0 përqind në 2002 në 1.2 përqind në 2008 por u rrit në 2.3 përqind në 2012. Rritja në varfërinë ndërmjet 2008 dhe 2012 ishte kryesisht për shkak të rritjes së varfërisë urbane si rezultat i krizës financiare globale.

► **Tabela 1.3. Indikatorët e varfërisë nga Anketa e Matjes së Standartit të Jetesës, 2002 – 2012**

Viti	2002	2005	2008	2012
Varfëria absolute				
Përqindja	25.4%	17.9%	12.5%	14.3%
Hendeku	5.7%	3.9%	2.4%	3.0%
Ashpërsia	1.9%	1.3%	0.7%	1.0%
Varfëria ekstreme				
Përqindja	4.7%	3.3%	1.2%	2.3%

Burimi: Instituti i Statistikave të Shqipërisë.

Tabela 1.4 përmbledh rezultatet e Anketimit të të Ardhurave dhe Kushteve të Jetesës në 2018. Nga ky anketim Instituti i Statistikave të Shqipërisë ka adoptuar indikatorët e varfërisë të bazuar në koncepte relative të varfërisë të përdorur nga statistikat e BE mbi të ardhurat dhe kushtet e jetesës (EU – SILC).² Sipas kësaj metodologjie indikator i kryesor është përqindja në rrezik varfërie. Ajo tregon përqindjen e personave që jetojnë në familje ku të ardhurat e disponueshme të ekuivalentuara janë nën kufirin e rrezikut të varfërisë. Kufiri i rrezikut të varfërisë është përcaktuar si 60 përqind e të ardhurave mediane të disponueshme të ekuivalentuara dhe të rregulluara nga shkalla ekuivalente e strukturës së familjes.³

► **Tabela 1.4. Indikatorët e varfërisë nga Anketa për Kushtet e Jetesës, 2017 – 2018**

Viti	2017	2018
Kufiri i rrezikut për të qenë i varfër (%) Popullsia nën 60% ose të ardhurat e disponueshme të medianës të ekuivalentuara	23.7%	23.4%
Kufiri i rrezikut të varfërisë në muaj; familje me një person (Lekë)	12,085	13,395
Kufiri i rrezikut të varfërisë në muaj; familje me një person (Dollarë)	101.47	123.96
Kufiri i rrezikut të varfërisë në muaj; familje me dy të rritur dhe dy fëmijë në varësi (Lekë)	25,378	28,130
Kufiri i rrezikut të varfërisë në muaj; familje me dy të rritur dhe dy fëmijë në varësi (Dollarë)	213.08	260.31
Përqindja e popullsisë në rrezik varfërie apo për përjashtim social	51.8%	49.0%
Koefiçienti GINI	0.368	0.354
Raporti S80/S20	7.5	7.0

Burimi: Instituti i Statistikave të Shqipërisë.

² (Shtuar sipas evidencave) Sipas sondazhit të vitit 2019, shkalla e rrezikut nga varfëria u ul lehtë në 23.0% me pragun 14,232 lekë në muaj. Koefiçienti Gini gjithashtu u ul në 0.343 dhe raporti midis pesësesh më të lartë dhe më të ulët të të ardhurave ishte 6.4.

³ Shkalla ekuivalente përcakton një peshë nga 1.0 për të rriturin e parë, 0.5 për çdo të rritur të tjerë, dhe 0.3 për çdo fëmijë tjetër që jeton në familje. Për shembull, shkalla ekuivalente e një familje me dy të rritur dhe dy fëmijë është $1 + 0.5 + 0.3 \times 2 = 2.1$

Kufiri i vlerësuar i rënies në varfëri për një person ishte 12,085 Lekë (101.5 Dollarë) në 2017 dhe 13,395 Lekë (124 Dollarë) në 2018. Për një familje me dy të rritur dhe dy fëmijë në varësi, shuma mesatare për person ishte 6,344 Lekë (53.3 Dollarë) në 2017 dhe 7,032 Lekë (65.1 Dollarë) në 2018. Niveli në shembullin në vijim është i krahasueshëm me nivelin e varfërisë absolute të përdorur në Anketën e Matjes së Standartit të Jetesës.

Është vlerësuar që 23.4 përqind e popullsisë, ose 672,000 persona, ishin në rrezik varfërie në 2018. Ky nivel është në mënyrë domethënëse më i lartë se të gjitha vendet e BE (përveç Rumanisë që rregjistroi 23.5 përqind në 2018). Përqindja e rrezikut në varfëri të shteteve anëtare të BE ishte 16.9 përqind në 2018. Përqindja e rrezikut të varfërisë është më e lartë në familjet me anëtarë të papunë (37.1 përqind në 2018) dhe familjet me fëmijë në varësi (27 përqind në 2018). Ndërmjet 2017 dhe 2018, pabarazia në të ardhura u ngushtua pak, sikurse vihet re nga rënia në koeficientin GINI nga 0.368 në 0.354. Në mënyrë të ngjashme u vu re rënia e moderuar për përqindjen e kuantilës së të ardhurave më të larta me kuantilen më të ardhura më të ulta nga 7.5 në 7.0.

Tabela 1.5 prezanton nivelet e rrezikut për të rënë në varfëri sipas gjinisë dhe grupeve të moshës. Nivelet e rrezikut për të rënë në varfëri janë pak më të larta tek femrat se sa tek meshkujt. Diferenca zgjerohet nga 0.4 pikë përqind në 2017 në 0.8 pikë përqind në 2018. Sipas grupeve të moshës, rezultatet tregojnë rrezik të rënies në varfëri për popullsinë e moshës nga 0 në 17 vjeç. Në veçanti, nivelet për femrat e kalojnë 30 përqind për 2017 dhe 2018. Nivele relativisht të ulta të rënies në varfëri për popullsinë në moshë mbi 65 vjeç i dedikohet programeve ekzistuese të transfertave sociale në veçanti përfitimeve nga pensionet (shih seksionin 3.3 për analiza të mëtejshme).

► **Tabela 1.5. Niveli i rrezikut të rënies në varfëri sipas grup moshave dhe gjinisë 2017 - 2018**

Grup moshë	2017			2018		
	Meshkuj	Femra	Totali	Meshkuj	Femra	Totali
0-17	27.7%	31.8%	29.6%	28.7%	30.6%	29.6%
18-64	24.0%	23.4%	23.7%	23.2%	23.3%	23.2%
65 ose më shumë	13.0%	13.7%	13.4%	12.5%	15.4%	14.0%
Totali	23.5%	23.9%	23.7%	23.0%	23.8%	23.4%

Burimi: Instituti i Statistikave të Shqipërisë.

2. Përshkrim i sistemit të mbrojtjes sociale të Shqipërisë

Në Shqipëri, reforma të rëndësishme të sistemeve të mbrojtjes sociale janë ndërmarrë gjatë viteve 1990. Ato përfshijnë ristrukturimin e sistemit të sigurimeve sociale që ekzistonte më parë, institucionet e sigurimit shëndetësor dhe të ndihmës sociale, gjithashtu futjen e pagesës së papunësisë dhe shërbimeve të punësimit.

Në 2006, Qeveria e Shqipërisë ratifikoi Konventën e ILO për Sigurimet Shoqërore (Standartet Minimale), (Nr. 102) 1952 për të moshuarit, vdekjet, sëmundjet, mëmësinë, paaftësinë, aksidentet në punë, degët e përkujdesit shëndetësor dhe të papunësisë. Ratifikimi demonstroi angazhimin e qeverisë së Shqipërisë për të mbajtur nivelet minimale të pranuar ndërkombëtarisht për përfitimet nga mbrojtja sociale.

Në këtë kapitull, ne përmbledhim strukturën ligjore dhe institucionale të sistemeve ekzistuese të mbrojtjes sociale në Shqipëri dhe përshkruhen dispozitat për përfitimet kryesore.

► 2.1. Kuadri ligjor dhe institucional

Në Shqipëri, e drejta për të pasur mbrojtje sociale është parashikuar nga Kushtetuta, në veçanti Nenet 49, 51, 52, 55, sikurse edhe ligjet specifike që rregullojnë përfitimet nga mbrojtja sociale. Ligjet kryesore mbi mbrojtjen sociale përfshijnë:

- Ligji Nr. 7703, datë 11.05.1993 “Për Sigurimet Shoqërore në Republikën e Shqipërisë”;
- Ligji Nr. 10383, datë 24.02.2011 “Për Sigurimet Shëndetësore të Detyrueshme në Republikën e Shqipërisë”;
- Ligji Nr. 9355, datë 10.03.2005, “Për Ndhimën dhe Shërbimet Shoqërore në Republikën e Shqipërisë”;
- Ligji Nr. 57, datë 18.07.2019, “Për Ndhimën Ekonomike në Republikën e Shqipërisë”; dhe
- Ligji Nr. 121, datë 24.11.2016, “Mbi Shërbimet e Përkujdesit Social në Republikën e Shqipërisë”.

Sistemi i mbrojtjes sociale në Shqipëri përbëhet nga përfitimet e sigurimeve sociale me bazë kontributet dhe shërbimet dhe ndihmën shoqërore të financuara nga taksat.

Mbulimi i sistemeve të sigurimit social kontributiv është për popullsinë ekonomikisht aktive, që përbëhet kryesisht nga punonjësit në ekonominë formale, megjithëse mbulimi i sigurimit shëndetësor është më i gjerë pasi shteti subvencionon kategori të caktuara të popullsisë ekonomikisht jo aktive.

Instituti i Sigurimeve Shoqërore (ISSH), një institucion publik i pavarur nën mbikqyrjen e Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë, është përgjegjës për administrimin e pensioneve të pleqërisë, pensioneve

të invaliditetit dhe ato familjare, përfitimeve nga aksidentet në punë, përfitimet nga sëmundjet dhe përfitimeve nga barrë-lindjet.

Shërbimi Shtetëror i Punësimit nën drejtimin politik të Ministrisë së Shëndetësisë dhe Çështjeve Sociale është përgjegjës për administrimin e përfitimeve të papunësisë.

Fondi i Sigurimit të Detyrueshëm të Kujdesit Shëndetësor është një institucion publik i pavarur i cili zbaton sigurimet shëndetësore në Shqipëri nën udhëzimet politike të Ministrisë së Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale.

Ndihma Sociale dhe Shërbimet e Kujdesit Social në Shqipëri përbëhen nga tre programet në vijim: (i) Ndihma Ekonomike e cila është një program ndihme sociale e kushtëzuar nga niveli i jetesës që siguron mbështetje në para apo në mallra, për familjet dhe individët në nevojë; (ii) Pagesat për aftësinë e kufizuar sigurojnë pagesa mujore për personat me aftësi të kufizuara të cilët nuk mund të përfitojnë nga skemat kontributive në mënyrë të ligjshme; (iii) Shërbimet e kujdesit social sigurojnë një diapazon të shërbimeve për individët dhe grupet në nevojë, të cilët nuk kanë mundësi të plotësojnë nevojat e tyre jetësore me burimet e tyre. Tabela 2.1 përmbledh kuadrin kryesor institucional.

Ministria e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale është përgjegjëse për hartimin dhe monitorimin e politikave për mbrojtjen sociale, duke përfshirë ndihmën ekonomike, paaftësinë dhe shërbimet e kujdesit social.

Shërbimi Social Shtetëror është një institucion publik nën mbikqyrjen e Ministrisë së Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale. Shërbimi Social Shtetëror është përgjegjës për zbatimin e pagesave të ndihmës ekonomike dhe aftësisë së kufizuar. Shërbimi Social Shtetëror punon në koordinim të ngushtë me punonjësit socialë në njësitë e shërbimeve sociale dhe të ndihmës ekonomike të ngritura në çdo bashki. Inspektorët e Ndihmës Ekonomike brenda Shërbimit Social Shtetëror në nivelet rajonale dhe qendrore janë përgjegjës për monitorimin si të ndihmës ekonomike ashtu edhe të programeve për pagesat e paaftësisë.

Inspektoriati Shtetëror i Punës dhe i Shërbimeve Sociale është përgjegjës për monitorimin e zbatimit të legjislacionit për përkujdesin social dhe të standarteve të kujdesit social. Megjithatë, kuadri përkatës i monitorimit dhe inspektimit për shërbimet e kujdesit social është në një fazë fillestare dhe standartet për monitorimin dhe raportimin janë akoma duke u zhvilluar.

Këshilli Bashkiak mund të aprovojë ndihmë sociale për familjet që kanë aplikuar nëpërmjet MIS por që nuk janë të ligjshëm për përfitim. Proçedura rregullohet nga një Instruksion i Ministrisë. Bashkitë mund të buxhetojnë deri në 6 përqind të shumës totale të ndihmës në para për këtë qëllim.

Njësitë e pushtetit vendor janë përgjegjës për shpërndarjen e ndihmës ekonomike dhe transferimit tek individët, kryefamiljarët dhe familjet. Njësitë e pushtetit vendor janë gjithashtu përgjegjës për shpërndarjen e shërbimeve të kujdesit social dhe bashkëpunimin me aktorë të tjerë dhe mbështetjen e tyre në kapacitetet për të siguruar shërbime. Administratorët Socialë brenda njërive të pushtetit vendor janë të ngarkuar për proçesin e aplikimit për ndihmë ekonomike. Vizita në shtëpi dhe vlerësimi social ekonomik i kushteve të familjeve kryhen nga administratorët socialë.

Agjensia Shtetërore për Mbrojtjen dhe të Drejtat e Fëmijëve është përgjegjëse për koordinimin dhe organizimin e sistemit të mbrojtjes së integruar të fëmijëve në linjë politikat kombëtare të mbrojtjes së fëmijëve, duke përfshirë zbatimin e ndërhyrjeve dhe ndërmarjeve e masave për parandalimin dhe mbrojtjen e fëmijëve nga abuzimet, neglizhimi, keqtrajtimi dhe dhuna.

Njësitë e Mbrojtjes së Fëmijëve dhe Vlerësimit të Nevojave dhe Njësitë e Referimit janë përgjegjëse për ndërtimin dhe menaxhimin e shërbimeve sociale në komunitetet vendore dhe përgatitjen e qendrave lokale për shërbime sociale. Këto njësi lokale nuk janë tërësisht të ndërtuara. Në veçanti, Njësitë Referuese dhe Vlerësimit të Nevojave nuk janë akoma në veprim.

► **Tabela 2.1. Kuadri institucional i shërbimeve të ndihmës ekonomike dhe kujdesit social**

Institucioni	Ndihma Ekonomike	Pagesa e paaftësisë	Shërbimet e kujdesit social-
Ministria e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale	Harton politika dhe kuadrin ligjor Drejton dhe monitoron veprimet reformuese të kryera nga entitetet respektive përgjegjëse. Zbaton aktualisht në nivel kombëtar projektin për Modernizimin e Ndihmës Ekonomike	Harton politika dhe kuadrin ligjor Aktualisht në fazën pilot të reformës	Harton politika dhe kuadrin ligjor Aktualisht duke vënë në funksionim axhendën e reformës së shërbimeve të kujdesit social
Institucioni Kombëtar i Mbrojtjes së të Drejtave të Njeriut (Avokati Popullit)	Përshkrim i rëndësishëm i situatës për bartësit e të drejtave, në veçanti për më të pamundurit.		
Shërbimi Social Shtetëror (zyra qendrore dhe 12 zyrat rajonale)	Menaxhimi, monitorimi dhe raportimi Përgjegjës për: <ul style="list-style-type: none"> • Administrimi i ndihmës në para • Zbatimi i formulës me Pikë • Administrimi i menaxhimit të sistemit të informacionit • Trainimi dhe Ndërtimi i Kapaciteteve 	Menaxhimi, monitorimi dhe raportimi <ul style="list-style-type: none"> • Administrimi i menaxhimit të sistemit të informacionit • Trainimi dhe Ndërtimi i Kapaciteteve 	Menaxhimi, monitorimi dhe raportimi Përgjegjës për: <ul style="list-style-type: none"> • Administrimi i institucioneve rezidenciale në nivel kombëtar • Drejtimi dhe mbështetja për vlerësimin, planifikimin dhe shpërndarjen e shërbimeve nga bashkitë • Trainimi dhe Ndërtimi i Kapaciteteve
Inspektoriati Shtetëror i Punës dhe Shërbimeve Sociale	—	—	Monitorimi dhe vlerësimi i standarteve të shërbimeve të kujdesit social.
Bashkitë (61 zyra)	<ul style="list-style-type: none"> • Shpërndan përfitimet e ndihmës ekonomike • Monitoron familjet përfituese • Administron bazën e të dhënave të përfituesve 	<ul style="list-style-type: none"> • Shpërndan përfitimet për personat me aftësi të kufizuar 	Harton politikat lokale Harton Planet e Kujdesit Social Përgjegjës për vlerësimin, planifikimin, administrimin dhe masat në nivel lokal të nevojave për shërbime të kujdesit social. Bartësit e detyrës së linjës së parë i cili ndërvepron me përfituesit jashtë institucioneve të specializuara Financimin dhe prokurimin e shërbimeve të kujdesit social

► 2.2. Dispozitat përfituese të skemave kontributive

(1) Pensionet e pleqërisë

Ndryshimi i Ligjit për Sigurimet Shoqërore (Ligji Nr. 7703 i 1993) në 2015 parashikon një rritje graduale në moshën e pensionit dhe periudhën e kërkuar të kontributit për një pension të plotë. Tabela 2.2 përmbledh masat tranzitore. Para vitit 2015, punonjësit në pension ishin të ligjshëm për pensione pleqërie nëse ata kishin kontribuar të paktën 15 vite (35 vite për një pension të plotë) dhe të kishin arritur moshën 65 vjeç për burrat dhe 60 vjeç për gratë. Në 2056, mosha e pensionit do të jetë 67 vjeç për të dyja gjinitë dhe periudha e kontributit për një pension të plotë do të jetë 40 vite.

Pensionet me moshë të reduktuar do të jenë të mundura për punonjësit që kanë kontribuar të paktën 35 vite dhe të kenë arritur moshën 62 vjeç për meshkujt dhe 57 vjeç për femrat. Pensioni reduktohet me 0.6 përqind për çdo vit të parashikuar nga mosha e pensionimit me ligj.

► Tabela 2.2. Kushtet e ligjshme për pensionet e të moshuarve

	Para 2015	Periudha tranzitore	Niveli përfundimtar
Mosha pensionimit për burrat	65 vjeç	Nga 2032, rritet me 1 muaj në vit	67 vjeç (2056 e në vijim)
Mosha e pensionimit për gratë	60 vjeç	Nga 2015, rritet me 2 muaj në vit	67 vjeç (2056 e në vijim)
Periudha e kontributit e kërkuar për pension të plotë	35 vjeç	Nga 2015, rritet me 4 muaj në vit	40 vite (2056 e në vijim)
Periudha e kontributit e kërkuar për pension	15 vjeç	...	15 vite

Burimi: Ligji Nr. 7703, datë 11.05.1993 "Mbi Sigurimet Shoqërore në Republikën e Shqipërisë", i ndryshuar.

Një pension për të moshuarit është i përbërë nga një sasi bazë dhe një rritje (një shtesë). Për një pension të plotë, masa bazë është e barabartë me pensionin social. Nëse periudha kontributive aktuale është më e shkurtër se periudha për një pension të plotë, masa e pensionit reduktohet në mënyrë proporcionale. Rritja është 1 përqind e kontributit bazë individual mbi periudhën e plotë të kontributit. Pensioni për të moshuarit që rezultojnë nuk duhet të jetë më i ulët se pensioni social.

(2) Pensionet e invaliditetit

Pensionet e invaliditetit ju paguhen punonjësve të cilët kanë humbur kapacitetin e tyre për punë (67 përqind ose më shumë paaftësi të plotë dhe ndërmjet 33 përqind dhe 67 përqind për paaftësi të pjesshme, të vlerësuar nga një Komision Mjekësor) dhe kanë qenë të siguruar për të paktën 75 përqind të periudhës që nga mosha 20 vjeç, duke përfshirë të paktën 1 vit në 5 vitet para se ti ndodhte paaftësia.

Pensioni i plotë i invaliditetit është llogaritur në mënyrë të ngjashme me pensionet e të moshuarve duke marrë parasysh periudhën më të shkurtër të kontributit. Pensioni i pjesshëm i invaliditetit është 50 përqind të pensionit të plotë të invaliditetit. Pensioni minimal i invaliditetit është 75 përqind të pagës minimale. Pagesa shtesë ju bëhen nëse përfituesi kërkon vëmendje konstante nga kujdestarët ose për fëmijët në varësi.

(3) Pensionet familjare (e të mbijetuarve)

Pensionet familjare (e të mbijetuarve) ju paguhen të afërmit të një pensionisti të sëmurë ose një punonjësi të siguruar të sëmurë. Gruaja e të mbijetuarit ka të drejtë nëse kujdeset për fëmijët në varësi deri në

moshën 8 vjeç, të paaftë, ose mbi 55 vjeç për të venë ose 60 vjeç për burrin që i ka vdekur gruaja. Jetimët janë të ligjshëm nëse ata janë në varësi dhe nën 18 vjeç (25 vjeç nëse janë student ose të paaftë).

Masa e pensionit për bashkëshortin/en e të mbijetuarit është 50 përqind e pensionit të të sëmurit. Masa e pensionit për jetimët e të mbijetuarit është 25 përqind (50 përqind nëse është jetim i plotë) e pensionit të të sëmurit për çdo fëmijë të ligjshëm. Masa totale e pensionit të të mbijetuarve nuk duhet të kalojë 100 përqind të pensionit të të sëmurit.

Përveç kësaj, ju paguhet një pagesë e menjëherëshme për funeralin ekuivalente me një muaj të pensionit bazë të të moshuarit të sëmurë.

(4) Përfitimet e mëmësisë

Përfitimet e barrë lindjes pëfitohen në rastet e shtatëzarisë dhe lindjeve dhe i paguhet gruas së siguruar për barrën dhe lindjen e fëmijës, kur ajo ka 12 muaj periudhë sigurimi, për çdo rast përfitimi. Përfitimet e mëmësisë në para përbëhen nga (i) përfitimet e lejes së mëmësisë, (ii) lejeve të mëmësisë për shkak të ndryshimit të punësimit, dhe (iii) granteve të lindjes.

Leja e barrë lindjes paguhet për deri në 365 ditë (të paktën 35 ditë para dhe 63 ditë pas ditës së pritshme të lindjes). Për lindje të disa fëmijëve (binjakë ose më shumë), periudha është 390 ditë (të paktën 60 ditë para dhe 63 ditë pas ditës së lindjes). Përfitimi është 80 përqind të pagës mesatare të punonjësit të siguruar për periudhën deri 150 ditë pas ditës së lindjes, dhe 50 përqind të pagës mesatare pas kësaj periudhe.

Përfitimet nga leja e mëmësisë mbulojnë humbjen e pagës për shkak të ndryshimeve në punësim prej shtatëzarisë.

Granti për lindjen është një shumë një herëshe e barabartë me 50 përqind të pagës minimale.

Në 2019, Qeveria Shqiptare futi një përfitim në para (bonusi për bebet e lindura) për të gjitha nënat që lindin fëmijë. Masa është 40,000 lekë për fëmijën e parë, 80,000 lekë për fëmijën e dytë, dhe 120,000 lekë për fëmijën e tretë e kështu me rradhë.

(5) Përfitimet nga sëmundjet

Pagesat për paaftësi nga sëmundjet i përfitojnë vetëm të punësuarit e siguruar të cilët janë të çertifikuar nga pikpamja mjekësore si të qënurit i pamundur përkohësisht që të punojë për shkak të sëmundjeve të përgjithshme. Nuk ka kërkesa për periudhën kontribuese, por niveli i përfitimit varet nga periudha e kontributit.

Përfitimi nga sëmundjet është 70 përqind i pagës mesatare të punonjësit të siguruar nëse periudha e kontributit është më pak se 10 vjet, dhe 80 përqind e pagës mesatare nëse periudha e kontributit është 10 vjet ose më shumë.

Pagesa e përfitimit nga sëmundjet për 14 ditët e para është detyrim i punëdhënësit. Përfitimi nga sëmundjet që paguhet nga skema e sigurimeve shoqërore fillon nga dita e 15-të për deri në 6 muaj (e cila mund të shtyhet deri në 3 muaj bazuar në çertifikatën e Komisionit Mjekësor).

Përfitimet nga sëmundjet paguhet edhe për punonjësit sezonalë dhe punonjësit e përkohshëm të cilët kanë qenë të siguruar të paktën për 3 muaj në 12 muajt paraardhës. Periudha maksimale është 75 ditë.

(6) Të ardhurat për paaftësi të përkohshme nga aksidentet në punë

Pagesë për paaftësi të përkohëshme nga aksidenti në punë ose sëmundjet profesionale, përfitojnë vetëm të punësuarit. Përfitimet nga aksidentet në punë përfshijnë (i) përfitimet në para për mungesën

e kapacitetit të përkohshëm për të punuar, (ii) pensione paaftësie për humbjen e përherëshme të kapacitetit për të punuar, dhe (iii) pensione për të mbijetuarit në rastin e vdekjeve.

Në rastin e humbjes së përkohshme të kapacitetit për punë, struktura e përfitimit është e ngjashme me përfitimet në para për shkak të sëmundjes por niveli është 100 përqind të pagës mesatare të punonjësit të siguruar dhe periudha maksimale është 12 muaj.

Në rastin e humbjes së përhershme të kapacitetit për punë, përfitimi i pensionit është sa 80 përqind e pagës mesatare të punonjësit të siguruar kur kemi humbje të kapacitetit për punë 67 përqind ose më shumë, 50 përqind deri 80 përqind të pagës mesatare për humbje të kapacitetit për punë ndërmjet 33 përqind deri 67 përqind. Pagesa shtesë ju paguhen sikurse për pagesat e pensioneve të paaftësisë. Pensioni minimal është 80 përqind e pagës minimale.

Nëse nga vlerësimi rezulton që humbja e kapacitetit për punë është të paktën 10 përqind por më pak se 33 përqind, një shumë një herëse ju paguhet në varësi të shkallës së paaftësisë.

Në rastin e vdekjes, përfitimet e pensionit janë të ngjashme me pensionet familjare dhe ju paguhen personave në varësi të punonjësit të sëmurë.

(7) Pagesa e papunësisë

Pagesën e papunësisë e përfitojnë personat e papunë të cilët kanë kontribuar të paktën 12 muaj. Përfituesit duhet të rregjistrohen në zyrat e punësimi si punë-kërkues. Pagesa e papunësisë është konstante në 50 përqind të pagës minimale. Periudha maksimale e pagesës nga papunësia është 3 muaj nëse kontributi i paguar është më pak se 5 vite; 9 muaj nëse kontributi i paguar shtrihet ndërmjet 5 dhe 10 viteve; dhe, 12 muaj nëse kontributi i paguar është 10 vite ose më shumë.

▶ 2.3. Dispozitat përfituese nga programet jo - kontributive

(1) Ndhima ekonomike

Përfituesit

Vendimi i Këshillit të Ministrave Nr. 597 i 2019⁴ përcakton që grupet në vijim duhet të përfitojnë nga ndihma ekonomike:

- ▶ familjet në nevojë të cilat nuk kanë të ardhura të mjaftueshme;
- ▶ jetimët të cilët nuk janë në institucionet e përkujdesit social;
- ▶ prindërit me më shumë se 2 fëmijë të lindur në të njëjtën kohë;
- ▶ viktimat e trafikimit, viktimat e dhunës në familje.

Duhet të theksohet që Ligji Nr. 9355 i 2005 përcakton që grupi i synuar si “familjet pa të ardhura ose me të ardhura të pamjaftueshme” pa një referencë tek familjet “në nevojë”. Vendosja e fjalëve në renditjen origjinale lejonte ndihmesë për familjet pa të ardhura por (akoma) jo në varfëri për rrjedhojë parandalimin e varfërisë. Dispozita e re ju kërkon familjeve që të jenë “në nevojë” për të përftuar përfitime.

⁴ Vendimi i Këshillit të Ministrave Nr. 597, datë 4.9.2019, për Përcaktimin e procedurave, dokumentacionit dhe shumës mujore të përfitimit të ndihmës ekonomike dhe përdorimit të fondit shtesë mbi fondin e ndihmës ekonomike të kushtëzuar.

Përfitimet

Përfitimet përbëhen nga pagesa mujore në para dhe përfitime në mallra. Masa e pagesës në para përcaktohet nga struktura familjare në përputhje me vendimin e Këshillit të Ministrave dhe varion nga 3,600 dhe 8,000 lekë. Masa maksimale e ndihmës ekonomike është 150 përqind e pensionit social, i cili është vendosur në nivelin e 30 përqind të pagës minimale.

Familjet përfituese me fëmijë të vegjël marrin një subvencion mujor shtesë për ata që janë në përputhje me kushte të caktuara që kanë të bëjnë me imunizimin dhe arsimin. Masa është 300 lekë për çdo fëmijë deri në moshën 16 vjeç që ndjek shkollën, 100 lekë për çdo vaksinim nga kalendari i vaksinimit. Përveç kësaj, familjet përfituese marrin kompensim për energjinë, tekste shkollore falas për fëmijët që ndjekin shkollën fillore dhe trajtim mjekësor falas për fëmijët deri në një vjeç, kopshte falas dhe kujdes mjekësor në shkolla, strehim social, bursa shkolle për fëmijët etj.

Ndihma ekonomike paguhet çdo muaj nëpërmjet bankave ose zyrave të postës. E drejta për të tërhequr pagesën e ndihmës ekonomike i takon gruas së kryefamiljarit.

Proçesi i aplikimit dhe e drejta për të përfituar

Tabela 2.3 më poshtë përmbledh rrjedhën e punës për proçesin e aplikimit. Për të aplikuar për ndihmë ekonomike, një anëtar i rritur i familjes nevojitet të ndërmarrë një intervistë me Administratorin Social në Bashki ose në njësitë administrative të cilët ndihmojnë gjithashtu që të plotësojnë formularët e aplikimit. Formularët duhet të dorëzohen gjatë 10 ditëve të para të muajit. Një fushatë informimi për publikun në nivel kombëtar për programin u përgatit me mbështetjen nga Banka Botërore për Projektin për Modernizimin e Ndihmës Ekonomike. Informimi është i mundshëm gjithashtu në të gjitha njësitë administrative, duke përfshirë zonat e largëta. Megjithatë familjet që jetojnë në zona të largëta disa herë përballen me vështirësi në aksesimin e zyrës. Disa qytete të mëdha të tilla si Tirana, Elbasani dhe Durrësi kanë integruar shërbime front desk (me një ndalim) për të shtuar aksesueshmërinë. Pavarësisht këtyre komunikimeve dhe përpjekjeve për tu shtrirë, administratorët socialë në diskutimet e grupeve fokale raportojnë që ndërkohë që programi ka qenë në funksion për më shumë se 28 vite, detajet e reformës së fundit janë akoma të panjohura për publikun.

Përveç familjeve që përpiqen të përfshihen në program, Administratorët Socialë në çdo njësi administrative luajnë një rol aktiv në kërkimin e familjeve potenciale për të përfituar dhe mbështetjen e tyre në proçesin e aplikimit. Stafi administrativ konsideron që njerëzit janë në përgjithësi në dijeni të proçesit të aplikimit ose e mësojnë atë gjatë aplikimit. Vështirësitë shtohen në familjet kur kryefamiljari është analfabet apo ku ka barriera gjuhësore. Ky është rasti i shpeshtë kur përfituesi është nga komunitetet Roma dhe Egjiptian.

Drejtorja Rajonale e Shërbimit Social Shtetëror vlerëson dhe vendos mbi kërkesat për pagesa të përfitimëve duke përdorur një metodë të vlerësimit të mjeteve në përdorim (formulë pikëzimi e unifikuar) që merr në konsideratë indikatorët e varfërisë në nivel familje. Formula përfshin rezultatet për kushtet e jetesës (tipi i ndërtesës, mobiljet, largësinë nga transporti publik, uji, energjia elektrike), mbrojtja sociale (nëse ndonjë anëtar i familjes ka përfituar 12 muajt e fundit), ose të ardhura të tjera apo kapitale, dhe shpenzime. Faktet sugjerojnë që formula e pikëzimit e unifikuar minimizon përfshirjen e gabimeve por çon në një përjashtim të familjeve në nevojë (shih seksionin 4.3).

Familjet përfituese duhet të rikonfirmojnë statusin e tyre social – ekonomik çdo 3 muaj për vijuar që ta marrin ndihmën. Periudha maksimale për të marë përfitimim është 5 vite. Ky kufizim kohor nuk aplikohet tek përfituesit mbi moshë punë dhe nënat e vetme. Brenda periudhës 5 vjeçare, përfituesit pritet që të përfshihen në tregun e punës nëpërmjet sistemeve përkatëse të referimit për përfshirjen ekonomike, psh nëpërmjet shërbimeve të punësimit, trainimit për aftësi ose programeve të tjera. Në 2018, 15,000 persona përdorën shërbimet e zyrave të punësimit, 4,266 persona u punësuan dhe 681 persona u rregjistruan në programet e trainimit profesional. Numri i familjeve që merrnin përfitime ishte 53,082 në 2018.

Të gjithë aplikantët për ndihmë ekonomike duhet të rregjistrohen çdo muaj si punëkërkuar të papunë. Stafi administrativ raporton që disa përfitues rezistojnë të marrin pjesë në programet e integritit ekonomik dhe që vetëm pak familje kanë lënë programin duke pranuar punësimin apo trainimin profesional, megjithatë pagesa nga puna mund të jetë disa herë më e lartë se ndihma ekonomike. Fakte qesharake tregojnë që kjo mund të jetë për shkak të faktit që familjet nuk duan të humbasin përfitimet e tjera të lidhura me ndihmën ekonomike dhe që në mjaft raste anëtarët e familjeve përfituese (madje edhe fëmijë) punojnë në mënyrë informale për të gjeneruar të ardhura shtesë.

Ndihma ekonomike nuk paguhet nëse një familje ka një anëtar të papunë i cili është i aftë për punë por nuk rregjistrohet në një zyrë punësimi si një punë kërkuar apo nuk pranon ofertat të përshtatshme për punë apo nuk rregjistrohet në trainime profesionale, apo ka një anëtar të punësuar i cili e ndërpret marrëdhënien e punës pa një justifikim të arsyeshëm. Përveç kësaj, ndihma ekonomike nuk paguhet nëse një familje ka bërë më shumë se një deklaram fallso për statusin e tyre social ekonomik.

► **Tabela 2.3. Hapat për përcaktimin e të drejtës për përfitim nga ndihma ekonomike**

Tipi i veprimit	Përgjegjësia	Denduria
Hapi i parë: Paraqitja e aplikimit nga drejtuesi i familjes		
Depozitohet një aplikim në zyrën e ndihmës ekonomike	Anëtar i rritur i familjes (mbështetur nga punonjësi social)	Çdo 3 muaj në vijim të aplikimit të parë
Realizon intervistën	Administrator social	Aplikimi i parë dhe çdo 3 muaj
Siguron dokumenta (Çertifikatë Familjare, ID të anëtarëve të rritur të familjes, Çertifikatë pronësie të tokës). Nëse është e aplikueshme: çertifikatë për ndjekje të shkollës të nxjerrë nga shkolla; fotokopje të rregjistrimit për shëndetin e fëmijës për vaksinat e bëra, kopje e noterizuar të statusit të jetimit	Kryefamiljari	Aplikimi i parë dhe çdo 3 muaj
Hapi i dytë: Hetimi i administratorit social dhe kontrolli i kryqëzuar i informacionit		
Fut të dhënat në Rregjistrin Elektronik Kombëtar	Administratori Social	Kur kryefamiljari aplikon për herë të parë sikurse kur kryefamiljari deklaron ndryshime në përbërje, statusin shëndetësor dhe kushtet e jetesës të familjes
Realizon një vizitë në shtëpi	Administratori Social	Brenda 3 muajve të aplikimit të parë dhe më pas dy herë në vit
Përgatit listën e aplikantëve dhe e dërgon atë në Këshillin Lokal	Administratori Social	Çdo muaj
Këshilli Lokal merr një vendim për familjet aplikuese dhe e dërgon atë zyrën Rajonale për përpunim të mëtejshëm	Këshilli Lokal	Çdo muaj
Hapi i tretë: Aprovimi apo refuzimi i aplikimit		
Përpunimi i të dhënave të familjes nëpërmjet formulës së pikëzimit	Zyra Rajonale	Çdo muaj
Kryqëzimi i informacionit të deklaruar nga familjari	Zyra Rajonale	Për aplikimet për herë të parë
Përgatitja e listës së përfituesve dhe listës së familjeve të refuzuara dhe dërgimi i tyre tek çdo bashki	Zyra Rajonale	Çdo muaj
Publikimi i listës së familjeve të përfituesve dhe të familjeve të refuzuara me një shpjegim se pse janë refuzuar	Zyra Rajonale	Çdo muaj
Apelimet/Ankesat		
Depozitimi i një anese	Anëtar i rritur i familjes	Brenda 20 ditëve

Aplikantët mund të depozitojnë një ankesë me shkrim kundër vendimit të Shërbimit Social Shtetëror së pari në nivel bashkie, dhe më vonë në nivel rajonal, dhe në fund mund të depozitojnë një proçedim në gjykatë. Nuk gjëndet asnjë statistikë zyrtare përsa i përket ankimimeve të rregjistruara, kohëzgjatjes së përgjigjeve ose nivelit të suksesit në apelim. Intervistat në grupet e fokusit me stafin administrativ lokal tregoi që sistemi apelimit me shkrim nuk ndiqet shpesh nga aplikantët pasi që ata preferojnë që të takojnë administratorin social, kryetarin e bashkisë apo drejtuesin e departamentit dhe ti kërkojnë llogari direkt rreth aplikimit të tyre.

Pas kompletimit të plotë të proçesit të aplikimit, dosja e aplikantit duhet të përmbajë të dhënat në vijim:

- Firmën e aplikantit në fomularin e aplikantit pas intervistës;
- Dokumenta shtesë të siguruar sikurse u listuan më sipër;
- Raportet e paraqitura nga administratori social mbi kushtet e jetesës të secilit kryefamiljar aplikues gjatë vizitave në shtëpi;
- Rezultatet pas përpunimit të të dhënave nëpërmjet formulës së pikëzimit dhe vendimin e zyrës rajonale;
- Ndryshimet e dokumentuara të kushteve të jetesës të familjes sikurse edhe statusin social/shëndetësor të anëtarëve të familjes.

Një sistem me të dhëna është ndërtuar brenda Rregjistrat Elektronik Kombëtar. Shërbimi Shtetëror Social është përgjegjës për mirëmbajtjen e të dhënave dhe rregjistrave.

Referimet

Ligji siguron ndërtimin e Njësive për Vlerësimin e Nevojave dhe Referimeve, një njësi speciale në administratën e qeverisë lokale, si një hyrje kryesore për të mundësuar një nevojë urgjente për vlerësim dhe referim rastesh. Megjithatë, këto njësi nuk janë ndërtuar në shumë bashki dhe kjo detyrë është realizuar nga punonjësit socialë. Ata punojnë ngushtësisht me zyrat e punës ose organizatat e tjera që sigurojnë shërbimet e kujdesit social dhe mund të ndihmojnë familjet të cilat nuk janë pranuar në ndihmën ekonomike. Pa këto njësi, shërbimet thelbësore të kujdesit social nuk janë dhënë në mënyrë sistematike (shih gjithashtu seksionin mbi shërbimet sociale më poshtë)

Flukset financiare

Ministria e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale transferon fondet e ndihmës ekonomike në çdo bashki çdo dy muaj.

Përveç përfituesve të identifikuar nëpërmjet formulës së unifikuar me pikë, bashkitë marrin një fond të kushtëzuar për “ndihmën ekonomike në bllok” për 3 përqind të buxhetit dhe mund të shtojnë nga buxheti lokal për të mbuluar deri në 6 përqind të buxhetit ekstra për të siguruar ndihmë ekonomike për aplikantët të cilët janë refuzuar nga sistemi i pikëzimit. Këto familje shtesë janë përzgjedhur bazuar në vlerësimin social – ekonomik të bërë nga Administratorët Socialë nga bashkitë.

Auditët financiarë të shpenzimeve të ndihmës ekonomike kryhen nga Inspektorët e Ndihmës Ekonomike dhe nga Administrata e Kontrollit të Lartë të Shtetit.

Monitorimi dhe vlerësimi

Sipas ligjit, roli i Inspektorit të Ndihmës Ekonomike është i lidhur shumë ngushtë me monitorimin e aktivitetit të zyrave të ndihmës ekonomike në nivel bashkie, kontrollin e dokumentave dhe kryerjen e vizitave në terren tek përfituesit, verifikon çdo thyerje të ligjit dhe propozon masa administrative apo financiare.

Aspektet kryesore për inspektorët për të kontrolluar përfshijnë, ndërmjet të tjerave, numrin e përfituesve të paligjshëm për ndihmë ekonomike dhe keqpërdorimin përkatës të fondeve, zbatimin e procedurave legale dhe cilësinë e dokumentave të paraqitura. Inspektorët gjithashtu dokumentojnë performancën e zyrave lokale.

Informacioni statistikor mbi numrin e përfituesve dhe masën e përfitimit (të ndara sipas numrit në familje) ju dërgohet çdo muaj nga njësitë e qeverisjes vendore në zyrat rajonale. Shërbimi Social Shtetëror merr raporte mujore nga inspektorët rajonal. Ky informacion më pas botohet, psh në websit-in e Institutit të Statistikave. Do të ishte e mirë që të përfshiheshin në ndarje sipas kritereve të tjera të informacioneve statistikore. Minimalja, duhet të përshinte ndarje sipas seksit, moshës dhe statusit të paaftësisë.

(2) Pagesa e paaftësisë

Sipas Vendimit të Këshillit të Ministrave Nr. 182 i 2020 "Mbi përcaktimin e masës, kritereve dhe procedurave dhe dokumentimit për vlerësimin dhe përfitimin e pagesave për personat me aftësi të kufizuar, sikurse edhe shoqëruesve personalë," pagesa e paaftësisë është e pagueshme për ata të cilët nuk janë kualifikuar për paaftësi nga sigurimet shoqërore ose pensione të aksidenteve në punë dhe kualifikohen në të paktën njërën nga këto kategoritë:

- personat me paaftësi të pamundur për të punuar;
- paraplegjik dhe tetraplegjik;
- invalidë të punës (personat e pamundur që të punojnë për shkak të aksidenteve apo sëmundjeve profesionale).

Vlerësimi i paaftësisë është përcaktuar në Vendimin e Këshillit të Ministrave Nr. 182 dhe drejtohet nga Komisioni Mjekësor i Caktimit të Aftësisë për Punë (KMSCAP). Komisionet mjekësore të nivelit të parë me nga pesë anëtarë secili janë krijuar:

- Dy komisione për shëndetin mendor, me psikopediatër dhe psikiatër;
- Një komision për kirurgji, onkologji, ortopedik dhe reumatologji, me ortoped, onkolog dhe reumatolog;
- Një komision për paraplegjik, tetraplegjik dhe neurologji, me neurologji;
- Një komision për sëmundje të brendshme (nefrologji, kardiologji, gastropatologji, endokrinologji, hematologji, pneumoalergji), me doktorë të sëmundjeve të brendshme, kardiolog, nefrolog dhe pneumoalergolog.

Individi mund të depozitohet një ankesë ndaj vendimit të nivelit të parë KMSCAP në këtë rast dosja e ankimuesit paraqitet në Komisionin Mjekësor Epror për Caktimin e Aftësisë për Punë. Ka katër Komisione Epre për sëmundjet e përgjithshme, sëmundjet e shëndetit mendor, paraplegjikët dhe tetraplegjikët dhe të verbërit, secili i përbërë nga pesë antarë.

Masa e pagesës së paaftësisë përcaktohet nga Këshilli i Ministrave. Në 2018, masa mujore e pagesës së paaftësisë është 10,850 lekë për paaftësitë që nuk kanë të bëjnë me punën, 10,330 lekë për paraplegjikët ose tetraplegjikët, dhe 11,730 lekë për të verbërit. E njëjta masë pagese ju paguhet edhe kujdestarëve nëse personi i paaftë ka nevojë për kujdes të vazhdueshëm nga të tjerët për të kryer nevojat ditore. Pagesa e paaftësisë dhe pagesa për asistencë personale indeksohen çdo vit nga Shërbimi Social Shtetëror bazuar në indeksin e çmimeve të konsumatorit.

Personat me paaftësi që ndjekin kurse të licensuara ose akredituara dhe studentët që ndjekin arsimin pas atij të mesëm marrin një pagesë dyfishë. Studentët që ndjekin arsimin e lartë në programe studimi të ciklit të parë apo të dytë marrin një pagesë të trefishtë.

(3) Pensioni social dhe programet speciale të qeverisë

Reforma e pensioneve e vitit 2015 futi konceptin e pensionit social i cili ju paguhet personave 70 vjeç e sipër dhe të cilët kanë jetuar në Shqipëri për të paktën 5 vitet e fundit dhe që nuk mund të kualifikohen për ndonjë pension. Kostoja e pensionit social mbulohet nga buxheti i shtetit.

Përveç kësaj, 511,747 persona përfituan nga kompensimet e çmimeve dhe 363,545 persona nga kompensimet e të ardhurave minimale në 2018. Qeveria shpenzoi 13,083 milion lekë, ekuivalente me 0.77 përqind të PPB me këto programe në 2018.

(4) Shërbimet e kujdesit social

Në Shqipëri, shërbimet e kujdesit social janë të përcaktuara si një komponent i sistemit të mbrojtjes sociale dhe si “një sistem i integruar dhe organizuar i përfitimeve dhe faciliteteve, që sigurohen nga praktikantët e fushave respektive të subjekteve publike ose jo – publike, me qëllim që të sigurojnë mirëqënien, pavarësinë dhe përfshirjen sociale të individëve dhe familjeve në nevojë për kujdes social”⁵.

Historikisht shërbimet e kujdesit social në Shqipëri janë zhvilluar nga organizata jo qeveritare gjatë viteve 1990. Shërbimet lokale të kujdesit social kanë qenë kryesisht të synuara nga grupet specifike (psh personat me paaftësi, viktimat e dhunës specifike), në zonat urbane. Që nga 2002, qeveritë në vijimësi kanë ndërmarrë një numër reformash të shërbimeve të kujdesit social, por procesi ka pasur hope dhe një zgjidhje e shëndetshme për financime të shërbimeve të kujdesit social nuk është arritur akoma.

Të drejtat ligjore për të përftuar shërbimet e kujdesit social sigurohen nga Ligji 121/2016 “Për shërbimet e kujdesit social në Republikën e Shqipërisë” për personat apo familjeve që jetojnë në Shqipëri të cilave ju mungojnë mjetet minimale thelbësore dhe për personat të cilët nuk janë në gjendje të plotësojnë nevojat e tyre të jetesës më vete apo nëpërmjet ndihmës së anëtarëve të familjes, për shkak të kushteve personale dhe sociale. Ligji identifikon grupet e mëposhtme të përfituesve:

- ▶ Familjet dhe fëmijët, sikurse fëmija i cili gëzon mbrojtje ndërkombëtare në Republikën e Shqipërisë, sipas legjislacionit në fuqi për azilin;
- ▶ Personat e paaftë;
- ▶ Të rritur të cilët kanë probleme sociale, viktimat e dhunës, viktimat e trafikimit, të alkoolizuarit dhe të droguarit;
- ▶ Vajzat shtatëzane ose prindër të vetëm të një fëmije deri në një vjeç;
- ▶ Fëmijë dhe të rinj në konflikt me ligjin të cilët kanë përmbushur periudhën e dënimit dhe të cilët kanë nevojë për shërbime të kujdesit social për ri-integrimin në shoqëri, sikurse edhe ata që gëzojnë mbrojtje ndërkombëtare nga vendime të autoriteteve përgjegjëse për azilimin dhe refugjatët në Republikën e Shqipërisë;
- ▶ Të moshuar në nevojë.

Ligji përcakton më tej tipet e shërbimeve në vijim:

- ▶ Shërbime para sociale që përbëhen nga a) informimi dhe këshillimi; b) shërbimet e kujdesit në shtëpi; c) mbështetja psiko – sociale; d) ndërhyrje të hershme;
- ▶ Shërbime në qendrat komunitare, përfshijnë qendrat zhvillimore; të dytat sigurojnë shërbimet në vijim:
 - a) terapitë intensive psiko – sociale për shërim mendor dhe rehabilitim social që synon integrimin në komunitet;

5. Ligji Nr. 121/2016 Për shërbimet e kujdesit social në Republikën e Shqipërisë, adaptuar 24 Nëntor 2016.

- b) shërbimet psikomotor për shërim dhe përmirësim të parametrave psikologjik dhe aftësive motore globale dhe të imta;
 - c) shërim të parametrave fizikë;
 - d) shërbime të specializuara ortofonike për shërimin e individëve me çrregullim të spektrit të autizmit apo aftësisë për komunikim;
 - e) shërim me terapi pune;
 - f) terapi zhvillimi.
- ▶ Shërbime në qendra rezidenciale, përfshin strehëzat;
 - ▶ Shërbimet sociale në situatë emergjence, përfshirë strehim të përkohshëm;
 - ▶ Shërbime alternative të kujdesit për fëmijë pa kujdes prindëror;
 - ▶ Shërbime të specializuara;
 - ▶ Shërbime të këshillimit nëpërmjet telefonit ose online.

Individët mund të kërkojnë akses në shërbime nëpërmjet punonjësve socialë dhe këshilli bashkiak vendos për kërkesën brenda 15 ditëve. Gjithashtu, punonjësi social mund të lëshojë një kërkesë direkte kur identifikohet një nevojë. Në rast se shërbimi nuk sigurohet nga qeverisja vendore, rasti mund ti referohet një njësie tjetër të qeverisjes vendore. Ligji përcakton më tej që menaxhimi i rastit dhe referimi mund të facilitohen nëpërmjet një rregjistri elektronik kombëtar, ku qeveritë lokale janë të detyruara të fusin të dhënat. Për më tepër, një njësi për vlerësim nevojash dhe referim rasti duhet të ndërtohet në çdo njësi administrative në bashki. Ky rregjister nuk është vënë akoma në punë deri në fund të vitit 2020.

3. Shpenzimet e mbrojtjes sociale dhe mjaftueshmëria e përfitimit

Ky kapitull prezanton shpenzimet për mbrojtjen sociale, analizon mbulimin dhe nivelin e përfitimeve, dhe vlerëson ndikimin e reduktimit të varfërisë nga përfitimet e mbrojtjes sociale.

► 3.1. Shpenzimet për mbrojtjen sociale

Tabela 3.1 përmbledh vlerësimet e shpenzimeve për mbrojtjen sociale në Shqipëri sipas degëve⁶. Tabela 3.2 krahason shpenzimet e sigurimit social sipas vendeve të përzgjedhura⁷. Shpenzimet sociale të Shqipërisë janë të karakterizuara nga një dominancë e pensioneve për të moshuarit të cilat llogariten në pothuajse 70 përqind të totalit të shpenzimeve për mbrojtjen sociale. Ndërkohë shpenzimet mbi pensionet e të moshuarve dhe për ndihmën ekonomike të Shqipërisë janë të krahasueshme me vendet fqinje, përfitimet që mbeten janë dukshëm nën ato të vendeve fqinje. Në 2017, Shqipëria shpenzoi 9.2 përqind të PBB për mbrojtjen sociale (duke përfshirë kujdesin shëndetësor) e cila ishte me pak se një e treta e mesatares së BE.

► Tabela 3.1. Shpenzimet e mbrojtjes sociale (duke përfshirë kujdesin shëndetësor) në Shqipëri të vlerësuara sipas përfitimeve, 2010 – 2017 (si një % ndaj PBB)

Viti	2010	2011	2012	2013	2014	2015	2016	2017
Totali	8.2%	8.3%	8.6%	9.2%	9.2%	9.1%	9.4%	9.3%
Vjetërsia	5.2%	5.4%	5.5%	5.8%	5.9%	6.1%	6.4%	6.4%
Sëmundja/paafësia	1.5%	1.5%	1.6%	1.8%	2.0%	1.7%	1.7%	1.7%
Mjetet e testuara	0.4%	0.4%	0.3%	0.3%	0.3%	0.3%	0.3%	0.3%
Mbijetuarit	0.3%	0.3%	0.3%	0.3%	0.3%	0.3%	0.3%	0.3%
Mëmësia/përfitimi për fëmijë	0.1%	0.1%	0.2%	0.2%	0.2%	0.2%	0.2%	0.2%
Papunësia	0.1%	0.1%	0.1%	0.1%	0.1%	0.1%	0.1%	0.1%
Shërbimi i kujdesit social	0.2%	0.2%	0.3%	0.3%	0.2%	0.2%	0.1%	0.1%
Social n.e.c.	0.2%	0.1%	0.1%	0.1%	0.1%	0.1%	0.1%	0.1%
Administrata	0.1%	0.1%	0.1%	0.1%	0.1%	0.1%	0.2%	0.1%

Burimi: Ymeri, S. 2019. ESPN Raporti Tematik për financimin e mbrojtjes sociale: Shqipëria, Rrjeti Europian i Politikave Sociale.

Shënim: n.e.c. = nuk klasifikohet diku tjetër.

⁶ Shpenzimet totale për mbrojtjen sociale publike në (Ymeri 2019) është e krahasueshme me të dhënat nga Instituti i Statistikave të Shqipërisë të mundshme vetëm pas 2014. Klasifikimi i përdorur nga (Ymeri 2019) ishte pak më i ndryshëm nga ai i përdorur në Eurostat. Ndihma ekonomike e llogaritur me mjetet e jetesës ishte përfshirë në përjashtimin social dhe askund tjetër i klasifikuar.

⁷ Në vitin 2017, shpenzimet e Fondit të Sigurimeve Shëndetësore ishin 2.6 përqind e PBB-së.

► Tabela 3.2. Shpenzimet për mbrojtjen sociale në disa vende, 2017 (si një % ndaj PBB)

	Shqipëria*	Mali Zi	Maqedonia Veriut	Serbia	Turqia	Bosnja dhe Herzegovina	BE 28	EA 19
Shpenzime totale	9.3%	17.4%	14.5%	19.5%	12.3%	18.8%	27.8%	28.9%
Social protection benefits	—	16.8%	14.3%	19.0%	12.1%	17.8%	26.8%	27.6%
Përfitimet mbrojtjes sociale	9.2%	12.3%	10.3%	14.3%	8.7%	13.0%	19.1%	19.7%
Vjetërsi	6.4%	6.7%	5.8%	8.8%	5.9%	5.1%	10.8%	10.9%
Sëmundje/kujdes shëndetësor	—	4.7%	4.2%	4.8%	3.3%	5.3%	7.9%	8.1%
Paaftësi	1.7%	1.5%	1.4%	1.2%	0.4%	2.8%	2.0%	2.0%
Mbijetuar	0.3%	2.1%	1.7%	1.8%	1.4%	3.5%	1.4%	1.8%
Papunësi	0.1%	0.3%	0.1%	0.6%	0.3%	0.4%	1.2%	1.4%
Familje/Fëmijë	0.2%	1.3%	0.9%	1.2%	0.5%	0.5%	2.3%	2.2%
Përrjashtim social	0.5%	0.4%	0.2%	0.6%	0.2%	0.2%	0.6%	0.6%
Strehim	—	0.0%	0.0%	0.0%	0.0%	0.0%	0.5%	0.4%
Shpenzime të tjera	0.0%	0.0%	0.2%	0.1%	0.0%	0.5%	0.3%	0.4%
Kosto administrative	0.1%	0.5%	0.0%	0.3%	0.2%	0.5%	0.8%	0.9%

Shënim: Shërbimet e mbrojtjes sociale në Shqipëri nuk përfshijnë kujdesin shëndetësor.

Burimi: Për Shqipërinë – Ymeri, S. 2019. Op.cit. Për vendet e tjera – të dhënat e EUROSTAT <https://ec.europa.eu/eurostat/web/social-protection/data/database>.

Siç është treguar në Tabelën 3.3, Shqipëria shpenzon 6.7 përqind të PBB për shëndetësinë. Ndërkohë që ky nivel është i krahasueshëm me vendet e tjera, pjesa e pagesave nga xhepi ishte 58.0 përqind çka e kalon pjesën e financimit publik. Pagesat nga xhepi janë burim mjerimi financiar dhe pengesash për të aksesuar kujdesin shëndetësor, veçanërisht për familjet me të ardhura të ulëta.

► Tabela 3.3. Shpenzimet shëndetësore sipas burimit të financimit në vendet e përzgjedhura, 2016-2017

	Shpenzimet shëndetësore korrente si % ndaj PBB	Burimi i financimit (% shpenzimeve shëndetësore korrente)	
		Shpenzimet qeveritare	Pagesa nga xhepi
Shqipëria	6.7	41.0	58.0
Bosnja dhe Herzegovina	8.9	70.5	29.1
Mali i Zi	7.6	75.0	24.1
Maqedonia e Veriut	6.1	67.4	31.9
Moldavia	7.0	50.6	43.6
Serbia	8.4	56.7	41.8
Ukraina	7.0	44.0	52.3

Burimi: OBSH të Dhënat për Shpenzimet Shëndetësore dhe Indikatorët e Zhvillimit Botëror.

► 3.2. Mbulimi me përfitime dhe mjaftueshmëria e përfitimeve

Në këtë seksion, ne analizojmë mbulimin me përfitime dhe nivelin e përfitimeve për çdo përfitim

(1) Pensionet e pleqërisë, paaftësisë dhe ato familjare

Tabela 3.4 përmbledh numrin e pensionistëve sipas tipit dhe skemës urban/rural. Numri total i pensionistëve të pleqërisë e kalon numrin e popullsisë 65 vjeç e sipër dhe mbulon më shumë se 90% të popullsisë në moshë 60 vjeç e sipër. Mosha mesatare e pensioneve të futura rishtaz në 2019 ishte 65.1 vjeç për meshkujt dhe 61.0 vjeç për femrat. Për shkak të mbulimit të madh të përfituesve me pensione pleqërie, numri i përfituesve me pensione sociale ishte vetëm 2,631 në 2018 në kundërshtim me parashikimin e vlerësimit fillestar për 5,000.

► Tabela 3.4. Numri i pensionistëve sipas tipeve dhe skemave urban/rural, 2011 – 2019

	2011	2012	2013	2014	2015	2016	2017	2018	2019
Kontribues									
Totali	735,448	651,613	561,169	654,563	718,070	718,286	752,383	778,111	781,924
Pensionet urbane	431,013	434,891	446,473	480,791	579,087	608,487	635,885	662,220	668,253
Pensionet rurale	261,097	168,513	64,274	127,728	89,527	53,168	58,526	58,940	61,563
Të tjerët	43,338	48,209	50,422	46,044	49,456	56,631	57,972	56,951	52,108
Pensionistët									
Urbane									
Të gjitha pensionet	390,956	399,959	418,399	436,337	454,163	472,390	488,408	508,651	530,331
Pensionet e pleqërisë	288,533	296,076	311,382	327,604	345,314	363,664	379,349	398,744	420,340
Pensionet e aftësisë së kufizuar	52,023	55,245	59,241	61,200	62,101	61,938	62,412	63,046	63,692
• aksidente të përgjithshme / sëmundjet	49,232	52,466	56,492	58,606	59,541	59,405	59,901	60,568	61,236
• lidhur me punën	2,787	2,775	2,745	2,590	2,557	2,530	2,508	2,475	2,453
Pensionet e të mbijetuarve	50,400	48,638	47,776	47,533	46,748	46,788	46,647	46,861	46,299
Rurale									
Të gjitha pensionet	157,719	154,143	152,024	149,146	144,769	139,154	132,778	127,084	121,208
Pensionet e pleqërisë	140,776	137,771	135,904	133,132	129,161	124,378	118,794	113,763	108,763
Pensionet e aftësisë së kufizuar	6,662	6,853	7,229	7,579	7,763	7,456	7,304	7,129	6,809
• aksidente të përgjithshme / sëmundjet	6,375	6,568	6,949	7,330	7,518	7,215	7,069	6,898	6,583
• lidhur me punën	287	285	280	249	245	241	235	231	226
Pensionet e të mbijetuarve	10,281	9,519	8,891	8,435	7,845	7,320	6,680	6,192	5,636
Urban + rural									
Të gjitha pensionet	548,675	554,102	570,423	585,483	598,932	611,544	621,186	635,735	651,539
Pensionet e pleqërisë	429,309	433,847	447,286	460,736	474,475	488,042	498,143	512,507	529,103
Pensionet e pleqërisë (si% e popullsisë 65+)	133.9%	132.4%	132.8%	132.7%	132.1%	132.7%	131.8%	131.7%	131.2%

	2011	2012	2013	2014	2015	2016	2017	2018	2019
Pensionet e pleqërisë (si% e popullsisë 60+)	95.6%	94.0%	94.4%	94.1%	93.3%	92.9%	91.8%	91.1%	90.8%
Shkalla e varësisë së sistemit									
Urban + rural	1.34	1.18	0.98	1.12	1.20	1.17	1.21	1.22	1.20
Urbane	1.10	1.09	1.07	1.10	1.28	1.29	1.30	1.30	1.26
Rurale	1.66	1.09	0.42	0.86	0.62	0.38	0.44	0.46	0.51
Shkalla e varësisë nga mosha e vjetër									
Urban + rural	1.71	1.50	1.25	1.42	1.51	1.47	1.51	1.52	1.48
Urbane	1.49	1.47	1.43	1.47	1.68	1.67	1.68	1.66	1.59
Rurale	1.85	1.22	0.47	0.96	0.69	0.43	0.49	0.52	0.57

Burimi: ISSH dhe llogaritje të vetat të ILO-s.

Tabela 3.5 prezanton të dhënat për pensionistët të ndara sipas gjinisë. Më shumë se 80 përqind e pensionistëve marrin përfitime nga skemat e pensioneve urbane. Shumica, burrat dhe gratë përfaqësohen pothuajse në mënyrë të barabartë. Megjithatë, vihet re që pothuajse 70 përqind e pensionistëve të moshuar nga skemat e pensioneve rurale janë femra.

► **Tabela 3.5. Numri i pensionistëve sipas gjinisë, tipit dhe skemave urbane/rurale, 2011-2019**

		2010	2011	2012	2013	2014	2015	2016	2017	2018	2019
Pensionet Rural+Urban	Totali	543,053	548,675	554,102	570,423	585,483	598,932	611,544	621,186	635,735	651,539
	Gra	264,539	268,062	275,118	286,761	294,367	302,337	304,825	310,881	321,513	330,294
	Burra	278,514	280,613	278,984	283,662	291,116	296,595	306,719	310,305	314,222	321,245
Pensione pleqërie	Total	427,890	429,309	433,847	447,286	460,736	474,475	488,042	498,143	512,507	529,103
	Gra	223,644	225,696	227,417	236,823	240,893	249,282	251,874	256,311	266,612	274,824
	Burra	204,246	203,613	206,430	210,463	219,843	225,193	236,168	241,832	245,895	254,279
Pensione invaliditeti	Totali	54,777	58,685	62,098	66,470	68,779	69,865	69,394	69,716	70,175	70,501
	Gra	21,241	22,680	24,070	25,914	28,087	28,401	28,419	28,742	29,204	29,368
	Burra	33,536	36,005	38,028	40,556	40,692	41,464	40,975	40,974	40,971	41,133
Pensione të mbijetuarve	Totali	60,386	60,681	58,157	56,667	55,968	54,594	54,108	53,327	53,053	51,935
	Gra	19,654	19,686	23,631	24,024	25,387	24,654	24,532	25,828	25,697	26,102
	Burra	40,732	40,995	34,526	32,643	30,581	29,940	29,576	27,499	27,356	25,833
Pensione urbane	Totali	384,187	390,956	399,959	418,399	436,337	454,163	472,390	488,408	508,651	530,331
	Gra	169,523	173,663	179,945	192,719	202,423	213,302	218,863	227,396	239,311	249,755
	Burra	214,664	217,293	220,014	225,680	233,914	240,861	253,527	261,012	269,340	280,576
Pensione pleqërie	Totali	285,875	288,533	296,076	311,382	327,604	345,315	363,664	379,349	398,744	420,340
	Gra	135,651	138,156	140,106	150,402	156,680	167,734	172,972	179,431	190,663	200,249
	Burra	150,224	150,377	155,970	160,980	170,924	177,581	190,692	199,918	208,081	220,091
Pensione invaliditeti	Totali	48,402	52,023	55,245	59,241	61,200	62,101	61,938	62,412	63,046	63,692
	Gra	18,600	19,966	21,279	22,934	24,850	25,001	25,192	25,569	26,033	26,337
	Burra	29,802	32,057	33,966	36,307	36,350	37,100	36,746	36,843	37,013	37,355

		2010	2011	2012	2013	2014	2015	2016	2017	2018	2019
Pensione të të mbijetuarve	Totali	49,910	50,400	48,638	47,776	47,533	46,749	46,788	46,647	46,861	46,299
	Gra	15,272	15,541	18,560	19,383	20,893	20,567	20,699	22,396	22,615	23,169
	Burra	34,638	34,859	30,078	28,393	26,640	26,182	26,089	24,251	24,246	23,130
Pensione rurale	Totali	158,866	157,719	154,143	152,024	149,146	144,769	139,154	132,778	127,084	121,208
	Gra	95,016	94,399	95,173	94,042	91,944	89,035	85,962	83,485	82,202	80,539
	Burra	63,850	63,320	58,970	57,982	57,202	55,734	53,192	49,293	44,882	40,669
Pensione pleqërie	Totali	142,015	140,776	137,771	135,904	133,132	129,160	124,378	118,794	113,763	108,763
	Gra	87,993	87,540	87,311	86,421	84,213	81,548	78,902	76,880	75,949	74,575
	Burra	54,022	53,236	50,460	49,483	48,919	47,612	45,476	41,914	37,814	34,188
Pensione invaliditeti	Totali	6,375	6,662	6,853	7,229	7,579	7,764	7,456	7,304	7,129	6,809
	Gra	2,641	2,714	2,791	2,980	3,237	3,400	3,227	3,173	3,171	3,031
	Burra	3,734	3,948	4,062	4,249	4,342	4,364	4,229	4,131	3,958	3,778
Pensione të të mbijetuarve	Totali	10,476	10,281	9,519	8,891	8,435	7,845	7,320	6,680	6,192	5,636
	Gra	4,382	4,145	5,071	4,641	4,494	4,087	3,833	3,432	3,082	2,933
	Burra	6,094	6,136	4,448	4,250	3,941	3,758	3,487	3,248	3,110	2,703

Burimi: ISSH.

Tabela 3.6 krahason pensionet mujore mesatare me pagat mesatare dhe pagën minimale. Nivelet e përfitimit ndryshojnë dukshëm ndërmjet skemave urbane dhe rurale. Pensioni mesatar i pleqërisë i skemës urbane përfaqëson 63 përqind të pages minimale, ose 31 përqind të pagës bruto mesatare.⁸ Pensioni mesatar i pleqërisë i skemës rurale përfaqëson diçka më shumë se 35 përqind të pagës minimale. Pensioni social është ndërtuar në nivel shumë të ulët në pothuajse 30 përqind të pagës minimale.⁹ Ka të dhëna të limituara mbi pensionet mesatare sipas seksit. Mesatarja e pensioneve të reja në 2019 për femrat ishte rreth 20 përqind më e ulët se e meshkujve, megjithëse moshë mesatare e pensionit për femrat është rreth 4 vite më e re se e meshkujve.

Për përfitimet që kanë të bëjnë me pensionet kontributive të pleqërisë, Konventa e ILO Nr. 102 kërkon që masa e përfitimit të pensionit (duke përfshirë çdo pagesë për familjen) për një përfitues standart (një person me gruan në varësi pa të drejta pensioni) me një periudhë pensioni për të paktën 30 vite duhet të jetë në nivelin e 40 përqind të të ardhurave të tij të mëparshme.

► **Tabela 3.6. Pensionet mesatare mujore sipas tipit dhe skemave urbane/rurale, 2012 - 2019**

	2012	2013	2014	2015	2016	2017	2018	2019
Shuma mesatare e pensionit mujor (lekë)								
Pensionet urbane								
Pleqëri	13,324	14,076	14,518	14,585	14,873	15,527	15,875	16,254
Paaftësia	11,738	12,181	12,593	12,648	12,803	13,390	13,817	14,258
Të mbijetuarit'	6,536	6,785	6,765	6,696	6,613	6,707	6,897	6,888
Pensionet rurale								
Pleqëri	7,457	7,465	7,825	8,330	8,556	8,808	8,792	9,165
Paaftësia	5,738	5,832	6,113	6,501	6,595	6,451	6,630	7,834

⁸ Pensioni mesatar i pleqërisë për skemat urbane përfaqëson 43.9 % të mesatares së llogaritur të kontributit bazë për punonjës.

⁹ Masa fillestare e pensionit social u përcaktua si pension pleqërie me 15 vite sigurime të pagës minimale sipas Ligjit të Sigurimeve Shoqërore përpara reformës së vitit 2015.

	2012	2013	2014	2015	2016	2017	2018	2019
Të mbijetuarit'	3,002	3,149	3,252	3,240	2,830	2,478	2,312	2,789
Pensioni social	—	—	—	6,750	6,858	7,064	7,262	7,465
	2012	2013	2014	2015	2016	2017	2018	2019
Si % e pagës mesatare								
Pensionet urbane								
Pleqëri	—	—	31.9%	30.4%	31.3%	31.7%	31.4%	31.0%
Paaftësia	—	—	27.7%	26.4%	26.9%	27.3%	27.3%	27.2%
Të mbijetuarit'	—	—	14.9%	14.0%	13.9%	13.7%	13.6%	13.2%
Pensionet rurale								
Pleqëri	—	—	17.2%	17.4%	18.0%	18.0%	17.4%	17.5%
Paaftësia	—	—	13.4%	13.6%	13.9%	13.2%	13.1%	15.0%
Të mbijetuarit'	—	—	7.1%	6.8%	6.0%	5.1%	4.6%	5.3%
Pensioni social	—	—	—	14.1%	14.4%	14.4%	14.4%	14.3%
Si % e pagës minimale								
Pensionet urbane								
Pleqëri	63.4%	64.0%	66.0%	66.3%	67.6%	64.7%	66.1%	62.5%
Paaftësia	55.9%	55.4%	57.2%	57.5%	58.2%	55.8%	57.6%	54.8%
Të mbijetuarit'	31.1%	30.8%	30.8%	30.4%	30.1%	27.9%	28.7%	26.5%
Pensionet rurale								
Pleqëri	35.5%	33.9%	35.6%	37.9%	38.9%	36.7%	36.6%	35.3%
Paaftësia	27.3%	26.5%	27.8%	29.6%	30.0%	26.9%	27.6%	30.1%
Të mbijetuarit'	14.3%	14.3%	14.8%	14.7%	12.9%	10.3%	9.6%	10.7%
Pensioni social	—	—	—	30.7%	31.2%	29.4%	30.3%	28.7%

Burimi: ISSH dhe llogaritjet e veta të ILO-s.

(2) Përfitimet nga mëmësia dhe sëmundjet

Tabela 3.7 prezanton numrin e përfituesve të mëmësisë dhe nga sëmundjet të paguara nga ISSH. Në këto vite, numri i përfituesve nga pagesat e mëmësisë si një përqindje e punonjësve femra ka pasur tendencë rënie me saduket për shkak të rënies së lindshmërisë. Kjo përqindje ka qenë mbi 4 përqind por ra në 3.63 përqind në 2019. Në 2018, numri mesatar i lejeve të mëmësisë ishte 288.4 ditë.

Numri i përfituesve të pagesave nga sëmundjet është dukshëm i ulët. Në veçanti numri i përfituesve të pagesave që kanë lidhje me sëmundjet (mungesë e përkohshme e kapacitetit për të punuar) është jashtëzakonisht i ulët, i cili ka qenë nën 60 gjatë gjithë periudhës.

► Tabela 3.7. Numri i përfituesve të pagesave afat – shkurtër, 2012 – 2019

	2012	2013	2014	2015	2016	2017	2018	2019
Mëmësia	11,989	—	12,113	3,808	14,403	15,322	15,649	14,251
Paaftësia e përkohshme (E përgjithshme)	2,779	—	1,116	1,485	1,419	5,400	1,971	1,249
Paaftësia e përkohshme (pasoje e punës)	47	—	25	38	29	37	59	45

	2012	2013	2014	2015	2016	2017	2018	2019
Mëmësia (si % ndaj femrave të punësuar dhe vetëpunësuar)	4.74%	—	4.63%	4.92%	4.14%	4.06%	4.06%	3.63%
Sëmundjet (përgjithësi) (si % ndaj punonjësve)	0.66%	—	0.26%	0.33%	0.30%	1.03%	0.36%	0.22%
Sëmundjet (pasojë e punës) (si % ndaj punonjësve)	0.011%	—	0.006%	0.009%	0.006%	0.007%	0.011%	0.008%

Burimi: ISSH dhe llogaritjet e veta të ILO-s.

(3) Pagesa e papunësisë

Tabela 3.8 përmbledh statistikat kryesore të pagesës së papunësisë. Është parë që numri i të papunëve të rregjistruar që marrin pagesë papunësie përfaqëson një përqindje shumë të vogël të totalit të personave të papunë. Përqindja ishte 5.3 përqind në 2010 por ka qenë në rënie dhe ka qëndruar në vetëm 1.7 përqind në 2019. Niveli i pagesës së papunësisë është fiksuar në 50 përqind të pagës minimale që nga 2018, por përfaqëson më pak se 25 përqind të pagës mesatare bruto.

Duhet të theksohet që vetëm 43 përqind e personave të papunë nga anketa e fuqisë punëtore aktualisht të rregjistruar në Shërbimin Shtetëror të Punësimit. Është vlerësuar që niveli i ulët i të papunëve të rregjistruar është për shkak të nivelit të lartë të aktivitetit ekonomik në sektorin informal. Në anën tjetër, rregjistrimi në Zyrën Shtetërore të Punës është një kusht i kërkuar për pagesën e papunësisë dhe ndihmën ekonomike. Në tremujorin e parë të 2020 vetëm 4.4 përqind e personave të papunë të rregjistruar merrnin pagesë papunësie dhe 34 përqind merrnin ndihmë ekonomike.

► Tabela 3.8. Numri i përfituesve dhe masa mujore e pagesës së papunësisë, 2010 – 2019

	2010	2011	2012	2013	2014	2015	2016	2017	2018	2019
Personat e papunë që marrin pagesë papunësie (persona)	9,265	8,537	9,772	7,824	7,395	6,186	5,141	2,178	2,050	2,870
Si % ndaj personave të papunë	5.3%	4.4%	5.5%	4.0%	3.4%	2.8%	2.5%	1.2%	1.2%	1.7%
Pagesa e papunësisë (lekë për muaj)	6,565	6,850	6,850	6,850	6,850	6,850	11,000	11,000	12,000	13,000
Si % ndaj pages minimale	34.6%	34.3%	32.6%	31.1%	31.1%	31.1%	50.0%	45.8%	50.0%	50.0%
Si % ndaj pages mesatare	—	—	—	—	15.0%	14.3%	23.1%	22.5%	23.7%	24.8%

Burimi: ISSH dhe llogaritjet e veta të ILO-s.

(4) Ndihma ekonomike

Tabela 3.9 përmbledh statistikat kryesore të programit të ndihmës ekonomike nga 2010 deri në 2019. Ka dy shëmbuj ku numri i familjeve përfituese ulet shpejt. Në vijim të futjes së formulës së pikëzimit (proxy means test) në tre rajone në 2013, numri i familjeve përfituese ra në 25% nga 104,398 në vitin 2013 në 78,071 në vitin 2014. Me aplikimin në nivel kombëtar të formulës së pikëzimit (proxy means test) në vitin 2018, numri i familjeve përfituese ra më tej në 33% nga 80,945 në vitin 2017 në 53,982 familje në vitin 2018.

Vlerësohet që 250,432 persona në 60,946 familje përfituan nga programi i NE në 2019. Numri i familjeve përfituese ra në veçanti për familjet me katër apo më pak anëtarë. Nëse ky është një indikacion i performancës së përmirësuar të targetimit apo jo duhet që të vlerësohet siç duhet. Shqetësimet rreth gabimeve për përjashtime të larta dhe mbulim të ulët të përgjithshëm të të varfërve (22 përqind në 2008) pavarësisht saktësisë së respektueshme të targetimit (82 përqind të përfitimeve arriti tek kuantili më i varfër) janë ngritur tashmë që përpara futjes formulës së pikëzimit (proxy means test) (Banka Botërore

2010). Në dritën e uljes së numrit të familjeve përfituese, pritet që akoma një pjesë e madhe e popullsisë së varfër të mos jetë e mbuluar nga skema e NE.

Nuk gjënden statistika rreth numrit të aplikimeve të rrefuzuara. Megjithatë, zyrtarët në 6 bashkitë pilot të Programit të Përbashkët të Kombeve të Bashkuara vlerësojnë që rreth 30 – 25 përqind të aplikantëve janë refuzuar për shkak të pikëve të ulta, fondeve të pamjaftueshme apo deklarimeve fallse.

Familjet përfituese kanë qenë në përgjithësi të mëdha, me shumë fëmijë, kushte të vështira në shtëpi dhe shpenzime më të ulta në familje në krahasim me ato që nuk janë të ligjshme. Një total prej 6,493 familjesh me kryefamiljare femër kanë përfituar nga skema në Dhjetor 2018, krahasuar me 4,277 në Janar 2018. Përveç këtyre në 2018, familjet përfituese përfshijnë 652 jetimë, 340 fëmijë me paaftësi, 3,313 persona me paaftësi të përhershme mbi 60 vjeç, 416 viktima të dhunës dhe trafikimit, 93,226 fëmijë nën 18 vjeç, 9,410 familje me persona të paaftë, 103 familje me trenjakë apo më shumë, dhe 9,527 familje Rome dhe Egjiptiane.¹⁰

Niveli i përfitimeve në 2019 shkon nga 2,011 lekë për një familje me një anëtar deri 7,724 lekë për një familje me 7 ose më shumë anëtarë. Kjo është ekuivalente me 7.7 përqind dhe 29.5 përqind të pagës mesatare respektive. Mesatarisht, niveli është më pak se 5 përqind i pagës mesatare për person. Kjo konsiderohet shumë e ulët nga stafi që punon në administratën publike dhe shumë larg të të mjaftuarit për një familje për të jetuar.

Buxheti i shpenzuar ishte pak nën 0.3 përqind të PBB por ra në 0.2 përqind në 2019. Masa mesatare e ndihmës ekonomike është në mënyrë konstante në një nivel të ulët nën 30 përqind të pagës minimale. Përfitimi për frymë bie me rritjen e numrit të antarëve të familjes. Në 2019, familjet me një anëtar merrnin 2,011 lekë për person, familjet me dy anëtarë 1,394 lekë, duke rënë në 1,125 lekë për person në familjet me 6 ose më shumë anëtarë.

► **Tabela 3.9. Numri i përfituesve dhe përfitimi mesatar i ndihmës ekonomike sipas numrit të anëtarëve në familje, 2010 – 2019**

	2010	2011	2012	2013	2014	2015	2016	2017	2018	2019
Numri i familjeve që marrin ndihmë ekonomike										
1 anëtar	6,462	6,478	5,484	5,641	3,854	4,406	4,301	4,582	1,643	1,572
2 anëtar	8,297	8,642	8,735	9,218	6,534	6,724	7,097	7,326	2,386	4,617
3 anëtar	13,740	14,389	15,036	16,581	12,517	13,188	13,821	14,352	9,156	11,384
4 anëtar	27,427	28,310	28,511	30,340	22,954	23,938	24,271	24,451	18,838	20,390
5 anëtar	21,466	21,701	21,751	22,998	17,699	18,124	17,963	17,867	13,692	14,089
6 anëtar	11,222	11,255	11,017	11,309	8,502	8,284	7,994	7,781	5,465	5,646
7 ose më shumë anëtarë	8,926	8,718	8,276	8,311	6,012	5,394	4,702	4,586	2,801	2,799
Totali	97,540	99,494	98,810	104,398	78,071	80,057	80,147	80,945	53,982	60,496
Perfitues të llogaritur	411,128	417,230	414,895	436,201	327,880	331,252	327,735	328,217	230,092	250,432
Si një % ndaj popullsisë	14.1%	14.4%	14.3%	15.1%	11.3%	11.5%	11.4%	11.4%	8.0%	8.7%
Totali i përfitimeve (milion lekë)	3 475	3 634	3 609	4 656	3 569	4 096	4 115	4 088	3 331	3 603
Si një % ndaj PBB	0.28%	0.28%	0.27%	0.34%	0.26%	0.29%	0.28%	0.26%	0.20%	0.21%
Përfitimi mesatar për familje (në lekë për muaj)										
1 anëtar	2,102	2,168	2,331	2,600	2,574	3,036	2,585	2,554	2,051	2,011
2 anëtar	2,444	2,447	2,393	2,984	2,872	3,173	3,191	3,252	2,781	2,787

¹⁰ Burimi: Vendimi i Këshillit të Ministrave nr. 866, datë 24.12.2019, - Për aprovimin e Strategjisë Kombëtare të Mbrojtjes Sociale, 2020 - 2023, dhe plani i veprimit për zbatimin e tij.

	2010	2011	2012	2013	2014	2015	2016	2017	2018	2019
3 anëtar	2,704	2,662	2,627	3,196	3,214	3,559	3,599	3,606	3,909	3,809
4 anëtar	2,829	2,919	2,925	3,628	3,599	4,145	4,208	4,257	4,931	4,927
5 anëtar	3,059	3,220	3,198	4,039	4,126	4,661	4,772	4,573	5,868	5,726
6 anëtar	3,553	3,642	3,650	4,350	4,800	5,319	5,383	5,318	6,695	6,751
7 ose më shumë anëtarë	3,969	4,113	4,159	4,893	5,339	5,915	6,070	5,727	7,831	7,724
Totali	2,969	3,044	3,044	3,716	3,810	4,264	4,279	4,209	5,142	4,963
Mesatarisht për person	704	726	725	889	907	1,030	1,046	1,038	1,206	1,199
	Përfitimi mesatar për familje (si % ndaj pagës minimale)									
1 anëtar	11.1%	10.8%	11.1%	11.8%	11.7%	13.8%	11.7%	10.6%	8.5%	7.7%
2 anëtar	12.9%	12.2%	11.4%	13.6%	13.1%	14.4%	14.5%	13.5%	11.6%	10.7%
3 anëtar	14.2%	13.3%	12.5%	14.5%	14.6%	16.2%	16.4%	15.0%	16.3%	14.6%
4 anëtar	14.9%	14.6%	13.9%	16.5%	16.4%	18.8%	19.1%	17.7%	20.5%	18.9%
5 anëtar	16.1%	16.1%	15.2%	18.4%	18.8%	21.2%	21.7%	19.1%	24.5%	22.0%
6 anëtar	18.7%	18.2%	17.4%	19.8%	21.8%	24.2%	24.5%	22.2%	27.9%	26.0%
7 ose më shumë anëtarë	20.9%	20.6%	19.8%	22.2%	24.3%	26.9%	27.6%	23.9%	32.6%	29.7%
Totali	15.6%	15.2%	14.5%	16.9%	17.3%	19.4%	19.4%	17.5%	21.4%	19.1%
Mesatarisht për person	3.7%	3.6%	3.5%	4.0%	4.1%	4.7%	4.8%	4.3%	5.0%	4.6%

Burimi: Instituti i Statistikave të Shqipërisë dhe llogaritjet e veta të ILO-s.

(5) Pagesa e paaftësisë

Tabela 3.10 prezanton numrin e përfituesve të pagesës së paaftësisë sipas tipeve. Shpenzimi për pagesat e paaftësisë ka qenë rreth 0.9 – 1.1 përqind të PPB përgjatë dekadës së fundit. Shpenzimi për pagesën e paaftësisë vlerësohet në 0.9 përqind të PPB në 2018, çka është më shumë se katër herë më shumë shpenzimit për ndihmën ekonomike.

Numri i përfituesve të pagesës së paaftësisë ishte 147,827 në fillim të vitit 2020, nga të cilët 74,658 persona ishin invalidë pune. Numri i përfituesve të pagesës së paaftësisë është më shumë se dy herë krahasuar me numrin e përfituesve të pensioneve të paaftësisë së sigurimeve shoqërore. Një rishikim i kuadrit ligjor dhe sistemit të vlerësimit të programit të pagesës së paaftësisë është duke u bërë me këndvështrim përmirësimin e transparancës dhe efijencës.

► **Tabela 3.10. Numri i përfituesve të pagesës së paaftësisë sipas llojit, 2015 – 2020 (në fillim të vitit)**

Viti	2015	2016	2017	2018	2019	2020
1. Personat me paaftësi (a+b+c)	68,826	66,905	66,788	67,669	69,504	73,169
me kujdestari	18,894	18,523	18,453	18,905	19,300	19,847
a. Të verbërit	12,568	12,239	12,089	12,118	12,244	12,694
me kujdestari	3,418	3,305	3,215	3,180	3,139	3,199
b. Personat paraplegjik - tetraplegjik	6,421	6,327	6,302	6,428	6,638	6,703
me kujdestari	6,347	6,267	6,235	6,339	6,520	6,639
c. Paaftësi mendore dhe fizike	49,837	48,339	48,397	49,123	50,622	53,772

Viti	2015	2016	2017	2018	2019	2020
prej të cilëve: me kujdestarë	9,129	8,951	9,003	9,386	9,641	10,009
2. Invalidët e punës	72,766	67,471	71,718	73,047	74,187	74,658
TOTALI	141,592	134,376	138,506	140,716	143,691	147,827
Pensionet e paaftësisë nga ISSH	69,864	69,394	69,716	70,175	70,501	—

Burimi: Shërbimi Social Shtetëror, Ministria e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale.

(6) Shërbimet e Kujdesit social

Sipas Shërbimit Social Shtetëror, mbulimi me kujdes social është esktrëmisht i ulët, me vetëm rreth 10,000 përdorues në 2019 (0.35 përqind të popullsisë). Shpenzimet për shërbimet sociale nga niveli qendror dhe lokal është shumë i ulët krahasuar me synimin ambicioz të vendosur në ligjin për sigurimin e një pakete bashkëkohore të shërbimeve në linjë me nevojën e popullsisë. Shpenzimi është akoma shumë i përqendruar në shërbimet rezidenciale në kontrast me prioritetin e njoftuar të qeverisë për de-institucionalizimin.

Shpenzimi në 2017 ishte 988 milion lekë (ose 0.3 përqind të Buxhetit total të qeverisë) dhe nga niveli qeverive lokale ishte 684 milion lekë (ose 0.9 përqind të buxhetit të tyre mesatar), me shpenzime për personelin që llogariten për më shumë se gjysma e kostos (53 përqind dhe 55 përqind respektivisht). Shpenzimet e qeverisë qendrore janë të fokusuar kryesisht në shërbimet rezidenciale dhe të kujdesit ditor dhe qeveritë vendore shpenzojnë kryesisht për çerdhe, qendra të kujdesit social dhe shërbime të tjera. Ndërkohë kostot për përfitues variojnë shumë në varësi të bashkive, kosto mesatare vjetore për përfitues në institucionet e kujdesit ditor për të moshuarit është 30,500 lekë, shumë më e ulët se për shërbimet e kujdesit ditor për fëmijët dhe të rritur me paaftësi që është në 334,000 lekë për përfitues mesatarisht apo për qendrat multifunkionale që janë në 158,000 lekë për përfitues. Shërbimet rezidenciale, sidomos për të rritur dhe persona me paaftësi janë më të lartat, mesatarisht në 534,000 lekë në vit për përfitues.

Një tipar i përbashkët i dispozitave të shërbimeve sociale është shpenzimi i lartë i tyre për kostot e personelit dhe një peshë relativisht e ulët e kostove operative dhe mirëmbajtjes çka pjesërisht mund të shpjegohet me faktin që disa bashki marrin mallra dhe shërbime në natyrë nga OJF-të dhe aktorë të tjerë.

► 3.3. Reduktimi i varfërisë me përfitimet nga mbrojtja sociale

Tabela 3.11 prezanton ndikimin e përfitimeve të mbrojtjes sociale në reduktimin e varfërisë bazuar në Anketën e Kushteve të Jetesës dhe të Ardhurat në 2018 (Shih gjithashtu Tabelën 1.4). Ajo gjithashtu përfaqëson raportin e përqindjes së varfërisë në nivele të ndryshme të kufijve. Sipas kesaj ankete, 49.0 përqind e popullsisë në rrezik varfërie apo përjashtimi social dhe 39 përqind e popullsisë ishte në rrezik varfërie, ku kufiri i rrezikut të varfërisë është përcaktuar si 60 përqind e medianës së të ardhurave të disponueshme të ekuivalentuara.

► **Tabela 3.11. Efektet e transfertave sociale në reduktimin e varfërisë, 2017 – 2018**


	2017	2018
Në rrezik të varfërisë apo të përjashtimit social	51.8%	49.0%
Në rrezik të varfërisë (60 % e të ardhurave mediane) përpara transfertës sociale	40.4%	39.0%
Në rrezik të varfërisë (60% e të ardhurave mediane) pas transfertës së pensionit	27.1%	26.3%
Reduktimi nga pensionet	13.3%	12.7%
Në rrezik të varfërisë (60% e të ardhurave mediane) pas të gjitha transfertave sociale	23.7%	23.4%
Reduktimi nga të gjitha transfertat sociale përveç pensioneve	3.4%	2.9%
Nën 50% të të ardhurave mediane	17.5%	17.3%
Nën 40% të të ardhurave mediane	11.8%	11.5%
Përqindja e popullsisë që marrin ndihmë ekonomike	11.4%	8.0%

Burimi: Instituti i Statistikave të Shqipërisë dhe llogaritjet e veta të ILO-s.

Sikurse tregohet në Figurën 3.1, pensionet familjare dhe të pleqërisë luajnë rolin e vetëm më të rëndësishëm në reduktimin e varfërisë ndërmjet programeve ekzistuese të transfertës sociale në Shqipëri. Në 2018, sistemi pensioneve kontribuoi në reduktimin e nivelit të rrezikut nga varfëria me 12.7 përqind pike, ndërkohë që transfertat e tjera sociale reduktuan më tej nivelin e rrezikut të varfërisë me 2.9 përqind - pikë. Sikurse është treguar më herët në Tabelën 1.5, për të dyja gjinitë, raporti për të qenë në rrezik varfërie për popullsinë në moshë 65 vjeç dhe më shumë është dukshëm më i ulët së mesatarja. Kjo sugjeron që një pjesë e madhe e përfituesve nga transfertat sociale janë të moshuarit të cilët mbështeten tek pensionet si burimi kryesor i të ardhurave. Duke e parë nga këndvështrimi i moshimit të popullsisë, sistemi i pensionit pritet të luajë një rol të rëndësishëm në rritje në reduktimin e varfërisë në veçanti ndërmjet të moshuarve.


Figura 3.2 tregon 17,3 përqind e popullsisë ishte me të ardhura familjare më pak se 50 përqind e të ardhurave mediane të ekuivalentuara të disponueshme, dhe 11.5 përqind e popullsisë ishte në të ardhura familjare më pak se 40 përqind të të ardhurave mediane të disponueshme të ekuivalentuara. Duhet parë që numri i vlerësuar i anëtarëve të familjeve që marrin ndihmë ekonomike është 8.0 përqind të popullsisë. Ky nivel është edhe më i ulët se përqindja e popullsisë nën 40 përqind të kufirit median të të ardhurave. Sikurse është vënë re tashmë, përqindja e përfituesve të ndihmës ekonomike ka rënë në mënyrë të dukshme nga 11.4 përqind në vitin 2017 në 8.0 përqind në vitin 2018.

► **Figura 3.1. Raporti i rrezikut të rënies në varfëri, 2018**



Burimi: Instituti i Statistikave të Shqipërisë dhe llogaritjet e veta të ILO-s.

► Figura 3.2. Efektet e transfertave sociale në reduktimin e varfërisë, 2017 – 2018



Burimi: Instituti i Statistikave të Shqipërisë dhe llogaritjet e veta të ILO-s.

4. Mbulimi dhe financimi i sistemeve të sigurimit social kontributiv

Ky kapitull diskuton çështjet korrente në mbulimin dhe situatën financiare të skemave kontributive të sigurimeve shoqërore dhe reformat në vijimësi të ndihmës ekonomike dhe shërbimeve të kujdesit social.

► 4.1. Mbulimi kontributiv i skemave të sigurimit shoqëror dhe shëndetësor

Instituti i Sigurimeve Shoqërore të Shqipërisë (ISSH) siguron të dhëna të kontribuesve sipas kategorisë (por jo sipas seksit). Tabela 4.1 krahason të dhënat e ISSH me të dhënat e Anketës së Forcës së Punës. Vihet re që vetëm 44.5 përqind e moshës për punë të popullsisë 20 – 64 vjeç në Shqipëri kontribuon në Sistemin e Sigurimeve Shoqërore në 2019. Ky hendek në mbulim mund të shpjegohet nga faktorët në vijim.

Në 2019, 24.1 përqind e popullsisë në moshë pune ishin ekonomisht jo aktivë.¹¹ Rreth 11.6 përqind e popullsisë ekonomisht aktive (ose 8.8 përqind e popullsisë në moshë pune) ishin të papunë.

Në Shqipëri, sikurse edhe në vende të tjera, prevalenca e ekonomisë informale dhe praktika e shpërndarë gjerësisht e punës së padeklaruar detyron sfida serioze për të zgjeruar mbulimin me sigurime shoqërore. Në Rekomandimin Nr. 204, termi “ekonomi informale” (gjithashtu i njohur si ekonomia “gri” apo “hije”) i referohet “të gjitha llojeve të aktiviteteve ekonomike nga punonjësit apo njësitë ekonomike që janë – me ligj apo në praktikë – jo të mbuluara ose të mbuluara jo mjaftueshëm nga rregullimet formale.”

Në Shqipëri gjithashtu, ka një numër në rritje të punonjësve në “forma jo - standarte të punësimit”, duke përfshirë punësimin e përkohshëm (periudhë të fiksuar) dhe punësim të rastësishëm, me kohë të pjesshme dhe punë me kërkesë, punësim në agjensi të përkohshme, apo marrëdhënie punësimi të kamufluara si vet-punësim. Përveç kësaj, ekonomia e ashtu quajtur “platformë” apo “gig” ka qenë në rritje në vitet e fundit. Këto tipe të reja të marrëdhënies së punës nuk janë në mënyrën e duhur të mbrojtura nga ligji i punës dhe ligji për sigurimet shoqërore.

Nga 1,180,000 popullsi e punësuar, numri i kontribuesve ishte 758,000, duke rezultuar në 67.1 përqind të nivelit të mbulimit kontributiv. Nga kjo 422,000 persona apo 32.9 përqind e popullsisë së punësuar nuk kontribuojnë në Sistemin e Sigurimeve Shoqërore. Nëse marrim në konsideratë vetëm popullsinë e punësuar me kohë të plotë, atëherë niveli i mbulimit kontributiv është 75.5 përqind.

11 Një numër i vogël i popullsisë inaktive ka një mbulim me sigurime shoqërore nga ISSH.

► Tabela 4.1. Mbulimi kontributiv i vlerësuar i popullsisë në moshë pune, 2019

Year	Numri (A)	Pjesa	Kontribues të llogaritur të ISSH (B)	Niveli i mbulimit: B/A	Popullsia e llogaritur që kontribuon: A-B
Popullsia (20-64) (I + II)	1,758,595	100.0%	781,923	44.5%	976,672
I. Popullsia ekonomikisht aktive (20-64) (i+ii)	1,335,321	75.9%	767,755	57.5%	567,566
i. Popullsia e punësuar (a+b+c)	1,180,451	67.1%	758,242	64.2%	422,209
– Me kohë të plotë	1,004,564	57.1%	758,242	75.5%	246,322
– Me kohë të pjesshme	175,887	10.0%	—	—	175,887
a. Punonjësit	570,158	32.4%	604,950	106.1%	–34,792
– Përhershëm	525,115	29.9%	604,950	115.2%	–79,835
– Përkohshëm	45,042	2.6%	—	—	45,042
b. Vetë-punësuar	368,301	20.9%	153,292	41.6%	215,009
c. Anëtarë në familje kontributive	241,992	13.8%	—	—	241,992
ii. Popullsi e papunë	154,870	8.8%	9,513	6.1%	145,357
II. Popullsi inaktive (20-64)	423,274	24.1%	14,168	3.3%	409,106

Burimi: Instituti i Statistikave të Shqipërisë dhe llogaritjet e veta të ILO-s.

Siç tregohet në Figurën 4.1, po të bëjmë disa supozime, mund të dilet në përfundimet në vijim.

- Numri total i kontribuesve në ISSH në ndërrmarjet publike dhe private ishte 605,000. Ky është i krahasueshëm me numrin e punonjësve në Anketën e Forcës së Punës.
- Numri total i kontribuesve të vet-punësuar (përfshirë të vet-punësuarit në bujqësi) dhe kontribuesit vullnetarë ishte 153,000, çka përfaqëson 41.6 përqind të të vet-punësuarve në Anketën e Forcës së Punës. Sipas këtij supozimi, 215,000 persona të vet-punësuar nuk janë të mbuluar nga Sistemi i Sigurimeve Shoqërore.
- Një person i punësuar i cili nuk është as punëdhënës as i vet-punësuar është klasifikuar si një punonjës kontribues familjar në Anketën e Forcës së Punës. Pretendohej që asnjë nga 242,000 punonjësit familjarë kontributiv, nga të cilët 60 përqind janë femra të mos jetë i mbuluar nga Sistemi i Sigurimeve Shoqërore.
- Duhet të vihet re që një përqindje e caktuar e kontribuesve raportojnë më pak se sa paga e tyre aktuale, edhe pse ndikimi i tij në të ardhurat e kontributit nuk dihet.

► Figura 4.1. Mbulimi i sigurimeve shoqërore sipas statusit në tregun e punës, 2019





Figura 4.2 tregon statusin e tregut të punës të popullsisë së Shqipërisë sipas seksit dhe grupeve të moshës.

► Figura 4.2. Statusi i tregut të punës sipas seksit dhe moshës, 2019



Burimi: Instituti i Statistikave të Shqipërisë dhe llogaritjet e veta të ILO-s.

Vëzhgimet e mëposhtme mund të bëhen.

- Ndërmjet të rinjve të moshës 15-24 vjeç, pjesëmarrja në forcën e punës është më pak se 40 përqind ndërkohë pjesa tjetër janë duke ndjekur shkollën, të angazhuar në përgjegjësitë shtëpiake dhe familjare, apo të dekurajuar për të kërkuar punë.¹² Pavarësisht nivelit të ulët të pjesëmarrjes në forcën e punës të kësaj grup moshe, niveli i papunësisë është i lartë (27.3 përqind në 2019) dhe pjesa e të punësuarve është e ulët (41.3 përqind në 2019).

¹² Në 2019, 26.6 përqind e popullsisë së re 15 - 29 vjeç nuk ishin as në punë as në arsim apo trainim.

- Në pjesën e parë të moshës për punë ndërmjet 25 dhe 54 vjeç, gratë tregojnë nivel më të ulët të pjesëmarrjes në forcën e punës dhe nga pjesa e të punësuarve se sa burrat kryesisht për shkak të detyrimeve familjare. Numri i anëtarëve kontributiv të familjes për gratë është dy herë më i madh se burrat në këtë grup moshe.
- Niveli i pjesëmarrjes në forcën e punës bie në mënyrë të dukshme për personat 65 vjeç për shkak të të drejtës për pensionim. Niveli i pjesëmarrjes së grave fillon të bjerë tashmë në grup moshën 55 – 64 vjeç, kryesisht për shkak të pensionit të hershëm tranzitor.¹³ Përçindja e atyre që nuk janë të punësuar është e lartë në këtë grup moshe për të dyja sekset veçanërisht për gratë.

Mbulimi i sigurimeve shoqërore (pension pleqërie, pensionet familjare, përfitime nga sëmundjet, përfitimet nga barrëlindja dhe pagesa e papunësisë) është e kufizuar në popullsinë që ka kapacitet kontributiv, që përbëhet kryesisht nga punonjësit në ekonominë formale. Në kontrast, mbulimi i sigurimit shëndetësor është më i gjerë pasi Shteti subvencionon popullsinë me një kapacitet të ulët kontributiv.¹⁴

Përveç kësaj, sigurimi shëndetësor mbulon kategoritë e mëposhtme të personave ekonomikisht jo-aktiv, kontributet e të cilëve financohen nga Buxheti i Shtetit:

- Përfituesit e pagesave të sigurimeve shoqërore apo pagesat e ndihmës ekonomike;
- Personat e papunë të rregjistruar në Shërbimin Kombëtar të Punësimit;
- Fëmijët nën 18 vjeç (nën 25 vjeç nëse janë në shkollë);
- Grupet e tjera të përcaktuara nga ligjet (p.sh. azil kërkuesit).

Nuk ka asnjë të dhënë për mbulimin e sigurimit shëndetësor. Sikurse tregohet në Tabelën 4.2, është parë që pothuajse katër milion persona (çka e kalon popullsinë rezidente) kanë zgjedhur doktorët e tyre të familjes.

► **Tabela 4.2. Përmbledhja e statistikave të shëndetësisë, 2017 – 2018**

	2017	2018
Popullsia në total e deklaruar nga doktorët e familjes	3,939,246	3,964,013
Urban	2,076,982	2,104,116
Rural	1,862,264	1,859,897
Numri doktorëve të përgjithshëm dhe praktikantëve	1,819	1,504
Numri i infermierëve dhe laborantëve teknike	6,831	6,784
Numri i doktorëve të specializuar	337	336
Numri i vizitave	6,434,350	6,668,567
Praktikantë të përgjithshëm dhe doktorë familje	5,976,976	6,219,039
Doktorë të specializuar	457,374	449,528
Numri mesatar i vizitave në ditë	11.1	11.8
Praktikantë të përgjithshëm dhe doktorë familje	11.3	12.3
Doktorë të specializuar	11.0	11.4

Burimi: Fondi i Sigurimeve Shëndetësore të Shqipërisë.

¹³ Moshë e pensionit sipas ligjit është 65 vjeç për burrat. Nga 2015 moshë e pensionit sipas ligjit për gratë është rritur me dy muaj për çdo vit derisa të arrijë 65 vjeç.

¹⁴ Gjithashtu ekziston sigurimi shëndetësor vullnetar.

Mbulim i ulët i sigurimit shoqëror dhe pasojat afat-gjata të tij.

Aktualisht vetëm 44.5 përqind e popullsisë me moshë 20–64 vjeç në Shqipëri kontribuojnë në Sistemin e Sigurimeve Shoqërore. Kur mbulimi kontributiv është në një nivel kaq të ulët, aplikimi i një parimi strikt kontributiv ndërmjet të pasurit të drejtë për përfitim dhe pagesës së kontributeve nënkupton që në afat gjatë më shumë se 55 përqind e personave të moshuar nuk do të kenë të drejtë për të pasur pensione nga kontributet. Reforma e pensioneve e vitit 2015, e cila shtrëngoi kushtet e pranueshmërisë, kufizoi më tej aksesin në të drejtën e pensionit.

Sikurse shihet më sipër, arsyt kryesore për mbulim të ulët janë: pjesëmarrje relativisht e ulët në forcën e punës dhe papunësia e lartë (në veçanti për të rinjtë dhe femrat), mungesa e rregjistrimit për shkak të informalitetit, dhe raportimi më i ulët i pagës. Nëse nuk merret ndonjë veprim për të zgjeruar mbulimin, kostot e garantimit të sigurisë së të ardhurave për të moshuarit thjesht do të kalojnë nga sistemi kontributiv në pensionin social të financuar nga buxheti i Shtetit.

Nivelet e kontributeve për sigurimet shoqërore dhe shëndetësore

Në Shqipëri, skemat kontributive të sigurimeve shoqërore luajnë një rol madhor në mbrojtjen sociale dhe të shëndetit. Mbulimi dhe pagesa e kontributeve të sigurimeve shoqërore janë të detyrueshme për të gjithë personat ekonomikisht aktivë, duke përfshirë të punësuarit dhe vet-punësuarit.

Kontributet e sigurimeve shoqërore llogariten si një përqindje e të ardhurave bruto mujore (janë të kushtëzuara nga minimumi dhe maksimumi). Tabela 4.3 prezanton nivelin e kontributit të sigurimeve shoqërore në 2020.

► Tabela 4.3. Niveli i kontributeve të sigurimeve shoqërore dhe sigurimeve shëndetësore, 2020

Të punësuarit

	Punëdhënësi	Punëmarrësi	Totali
ISSH (Total)	15.0%	9.5%	24.5%
- Pensionet	12.79%	8.81%	21.6%
- Mëmësia	0.83%	0.57%	1.4%
- Sëmundjet	0.18%	0.12%	0.3%
- Aksidentet në punë	0.3%	—	0.3%
- Papunësia	0.9%	—	0.9%
Sigurimi shëndetësor	1.7%	1.7%	3.4%
Total (ISSH+SSh)	16.7%	11.2%	27.9%

Minimumi i kontributeve bazë = 26,000 lekë, Maksimumi i kontributeve bazë = 114,670 lekë.

Të Vetë - punësuarit

	Total	Në lekë (mujor)
ISSH (Total)	23.0%	5,980
- Pensionet	21.6%	5,616
- Mëmësia	1.4%	364
- Sëmundjet	—	—

	Total	Në lekë (mujo)
- Aksidentet në punë	—	—
- Papunësia	—	—
Sigurimi shëndetësor	3.4%	1,768
Total (ISSH+SSh)	26.4%	7,748

Kontributi bazë për ISSH =26,000 lekë, Kontributi bazë për Sigurimin Shëndetësor = 52,000 lekë.

Për punonjësit, kontributet për pensionet, sëmundjet dhe perfitimet e barrëindjes janë të ndara ndërmjet punëdhënësve dhe punëtorëve në raport 6 : 4, ndërkohë pagesa e kontributeve për aksidentet në punë (aksidentet në punë dhe sëmundjet profesionale) dhe pagesa e papunësisë është përgjegjësi e vetme e punëdhënësit. Kontributet e sigurimeve shëndetësore janë të ndara barabartë ndërmjet punëdhënësit dhe punëmarrësit.

Në 2020 niveli i kontributeve të sigurimit shoqëror në total për punonjësin është 27.9 përqind, të përbërë nga 24.5 përqind për sigurimet shoqërore dhe 3.4 përqind për sigurimet shëndetësore. Niveli i detyrueshëm i kontributeve që ju atribuohet punonjësve është 11.2 përqind, ndërkohë niveli i detyrueshëm i kontributeve që i atribuohen punëdhënësit është 16.7 përqind. Bazat e kontributit minimal dhe maksimal mujo janë 26,000 lekë dhe 114,670 lekë respektivisht.

Të vetë-punësuarit (përveç të vetë-punësuarve në bujqësi) janë përgjegjës për të paguar vlerën totale të kontributeve të sigurimeve shoqërore. Megjithatë ata nuk janë të mbuluar (për rrjedhojë nuk janë përgjegjës për të paguar kontribute) për sëmundjet, aksidentet në punë dhe pagesën e papunësisë. Kontributi për të vetë-punësuarin është konstant bazuar në pagën minimale për sigurimet shoqërore dhe dyfishin e pagës minimale për sigurimin shëndetësor (i ndryshuar për zonat urbane dhe rurale).

Për sigurimet shëndetësore, kontributi i shtetit ndaj personave ekonomikisht inaktivë bazohet në konsumin për frymë të kujdesit shëndetësor të përcaktuar nga Fondi dhe aprovuar nga buxheti.

Ministria e Financave mbledh kontributet e sigurimeve shoqërore dhe shëndetësore nëpërmjet Drejtorisë së Përgjithshme të Taksave. ISSH mbledh kontributet nga fermerët e vetë-punësuar të cilët kontribuojnë në skemën rurale.

Nën raportimi i pagave kontributore

Përveç mbizotërimit të ekonomisë informale, puna e padeklaruar është problem me rrënjë të thella në Shqipëri. Këtu, puna e padeklaruar i referohet një situate të punësimit informal në të cilën punëtorët dhe punëdhënësit deklarojnë një të ardhur më të ulët se është aktualisht në institucionet publike për të shmangur taksat dhe kontributet e sigurimeve shoqërore.

Për sistemin e kontributeve të sigurimeve shoqërore, puna e padeklaruar nënkupton mashtrim dhe evazion të taksave dhe kontributeve të sigurimeve shoqërore. Në mënyrën më tipike, një punonjës dhe punëdhënësi i tyre raportojnë vetëm nivelin minimal të kontributeve të përcaktuar nga ligji, ndërkohë pjesa e mbetur e pagës së tyre ju paguhet direkt dhe në mënyrë informale si pagesë në para në zarf. Kjo siguron të paktën një nivel të caktuar përfitimi nëse punonjësi kompletion periudhën e kërkuar të kontributit. Në këtë mënyrë puna e padeklaruar minon seriozisht qëndrueshmërinë e sistemit të sigurimit shoqëror dhe mjaftueshmërinë e përfitimeve.

Në 2019, baza mesatare e vlerësuar e kontributeve për punonjësit është 37,007 lekë¹⁵, çka është 70.7 përqind e pagës mesatare bruto¹⁶. Figura 4.3 tregon shpërndarjen e pagës kontribuese në ISSH nga 2017


¹⁵ E vlerësuar nga sasia totale e kontributeve, numri mesatar i punonjësve që kontribuojnë, dhe niveli i kontributeve.

¹⁶ Paga mesatare bruto e vitit 2019 ishte 52,376 lekë nga Anketa e Fuqisë Punëtore.

deri 2019. Rreth 55 përqind e punonjësve kontribuojnë nën pagën mesatare dhe ka një përqendrim të rëndësishëm të pagës kontribuese në pagën minimale kontribuese. Këto vëzhgime mund të përcillen si fakte të nën raportimit të pagës.

Burime të ndryshme tregojnë një numër në rritje të formave jo standarte të punësimit në Shqipëri. Ashtu sikurse studimi i fundit tregon, puna e padeklaruar mbivendoset me forma jo standarte të punës ose vetë-punësimit, dhe në disa raste këto forma mund të përdoren si instrumenta për evazion të taksave dhe kontributeve (Platforma Europiane për Trajtimin e Punës së Padeklaruar, 2018).

► Figura 4.3. Shpërndarja e pagave kontribuese për Institutin e Sigurimeve Shoqërore, 2017 – 2019.



Burimi: ISSH.

► 4.2. Statusi financiar i Sigurimeve Shoqërore dhe Fondit të Sigurimit Shëndetësor.

Tabela 4.4 prezanton të ardhurat dhe shpenzimet e Fondit të Sigurimit Shoqëror nga 2011 deri 2019. Vihet re që ISSH vepron gjithashtu si një agjensi pagesash i programeve speciale që financohen nga buxheti i shtetit.¹⁷ Gjithashtu vihet re që skema e pensioneve suplementare nuk është e përfshirë në këtë tabelë.

¹⁷ Këto programe speciale përfshijnë: kompensimet e çmimeve, kompensimet për të ardhurat minimale, pensionet sociale, pensionet special si dhe pensionet për kategoritë speciale (invalidët e luftës dhe veteranët e luftës).

► **Tabela 4.4. Të ardhurat dhe shpenzimet e Fondit të Sigurimeve Shoqërore (përfitimet detyruese), 2011 – 2019. (në milion lekë)**

		2011	2012	2013	2014	2015	2016	2017	2018	2019
Te ardhurat	A	67,725	65,857	69,797	77,486	76,501	80,351	86,958	95,955	98,906
Kontributet nga punëdhënësit dhe punëmarrësit	A1	47,884	48,61	50,738	61,216	59,146	65,247	72,237	77,971	82,747
– Nga punonjësit		44,543	45,738	47,588	52,464	56,473	62,692	69,433	74,525	79,404
– Nga të vetë-punësuarit		2,538	2,009	2,382	7,745	2,028	1,993	2,111	2,122	2,213
Kontributet nga buxheti i shtetit	A2	10,773	7,988	9,552	6,751	5,794	5,022	4,68	4,902	4,436
Programet speciale te financuara nga Buxheti i shtetit	A3	9,068	9,259	9,507	9,519	11,561	10,082	10,041	13,082	11,723
Shpenzimet	B	80,428	84,880	90,807	96,791	102,417	109,303	114,148	120,642	126,044
Përfitimet	B1	69,737	74,100	79,632	85,296	88,904	93,457	100,174	105,426	112,027
– Pensionet		67,471	71,632	76,877	82,357	86,071	90,529	96,771	101,571	107,880
– Mëmësia		1,891	2,076	2,334	2,536	2,49	2,578	3,018	3,384	6,604
– Sëmundjet		364	381	410	393	331	337	371	447	521
– Aksidentet në punë		12	11	11	10	12	13	14	24	21
Shpenzimet administrative	B2	1,653	1,718	1,973	1,862	2,016	2,159	2,145	2,134	2,294
Shpenzimet për programet speciale	B3	9,038	9,062	9,202	9,633	11,497	13,687	11,829	13,082	11,723
Deficiti financiar nga buxheti shtetit	B-A	12,827	19,104	21,073	19,388	26,003	29,026	27,191	24,687	27,137
Deficiti financiar nga buxheti shtetit si % ndaj PBB		0.99%	1.43%	1.56%	1.39%	1.81%	1.97%	1.75%	1.51%	1.58%
Kontributet e veta si % ndaj shpenzimeve te saj	A1/(B1+B2-A2)	79.0%	71.7%	70.4%	76.1%	69.5%	72.0%	74.0%	76.0%	75.3%

Burimi: Llogaritjet e vetë ISSH dhe ILO.

Sikurse tregohet në Figurën 4.4 kontributet nuk janë të mjaftueshme për të mbuluar shpenzimet. Si rezultat, Fondi ka qenë në deficit në nivel ndërmjet 1 dhe 1.6 përqind të PBB. Kjo sugjeron nevojën për të përmirësuar më tej qëndrueshmërinë afat-gjatë të Fondit të Sigurimeve Shoqërore.

► Figura 4.4. Të ardhurat dhe shpenzimet e Fondit të Sigurimeve Shoqërore, 2011-2019




Tabela 4.5 prezanton të ardhurat dhe shpenzimet e Fondit të Sigurimit Shëndetësor nga 2013 deri 2019. Fondi ka qenë në ekuilibër. Duhet të vihet re që ana e të ardhurave të Fondit është mbështetur nga buxheti i Shtetit. Në fakt, transferta totale nga buxheti i Shtetit është më shumë se dyfishi i kontributeve vetë.

► Tabela 4.5. Të ardhurat dhe shpenzimet e Fondit të Sigurimit Shëndetësor, 2011–2018 (në milion lekë)

	2011	2012	2013	2014	2015	2016	2017	2018
Të ardhurat	13,965	15,493	30,612	32,481	34,769	35,751	38,229	40,106
Kontributet	6,029	6,246	7,294	8,008	9,391	10,545	12,268	12,250
Transfertat nga Buxheti Shtetit	7,812	9,057	23,202	24,338	25,193	24,969	25,869	27,796
- Për kujdesin parësor	—	—	9,367	8,575	8,859	8,020	6,782	7,481
- Për shërbimin spitalor	—	—	13,836	15,763	16,334	16,949	19,087	20,315
Të ardhura të tjera	124	190	115	135	186	238	92	60
Shpenzimet	0	15,493	29,494	31,399	32,142	34,920	40,285	42,018
Shërbimet e kujdesit parësor	—	6,260	6,525	6,687	6,778	7,785	8,017	7,845
Rimbursimi ilaceve	—	7,881	8,420	8,251	8,110	8,425	10,453	11,020
Investimet	—	10	—	—	—	71	1	84
Shpenzimet administrative	—	657	—	—	—	808	845	748
Shërbimi spitalor	—	—	14,549	16,461	17,254	17,831	20,135	21,529
Spitali Durrësit	—	685	—	—	—	—	834	792
Shpenzime (si % ndaj PBB)	0.0%	1.2%	2.2%	2.3%	2.2%	2.4%	2.6%	2.6%

Burimi: Fond i Sigurimit Shëndetësor i Shqipërisë dhe llogaritjet e veta të ILO-s.

► 4.3. Reformat e ndihmës ekonomike dhe shërbimeve të kujdesit social

Reforma e ndihmës ekonomike: ndihma ekonomike

Shqipëria në vitet e fundit ka zbatuar reforma në programet e ndihmës ekonomike në para (kryesisht programin e ndihmës ekonomike dhe programin e pagesave të paaftësisë) me mbështetjen nga Banka Botërore, në veçanti nën Projektin për Modernizimin e Ndhmës Ekonomike. Reformat synuan të shpërndajnë burimet në mënyrë më efektive tek më të varfërit dhe më të pamundurit në shoqëri.

Faza e parë e projektit të mësipërm u fokusua në reformimin e programit të ndihmës ekonomike, që rezultoi në zbatimin e Rregjistrimit Elektronik Kombëtar dhe një sistem informacioni të automatizuar për menaxhimin e performancës dhe futjen e një formule pikëzimi të standartizuar të llogaritjes së mjeteve të jetesës, ndryshimeve në kriteret e përfitimit, dhe ndryshime në diapazonin e përfitimeve dhe shërbimeve të përshkruara në seksionin 2.3.

Sipas vlerësimit të ndikimit të programit të ndihmës ekonomike të kryer në 1998 nga Banka Botërore¹⁸, “ndihma ekonomike në Shqipëri është shumë e dobët targetuar tek të varfërit” dhe ajo “tejkalon atë që duhet të pritet mbi bazën e indikatorëve të llogaritur nga targetimi i vetëm”. Në të njëjtën kohë, vihet re që “një numër i të varfërve janë përjashtuar nga ndihma ekonomike” dhe që “një kriter objektiv i qartë për të përcaktuar masën e grantit nga qendra drejt komunave” mungon.

Në kuadër të vlerësimit të ndikimit të komponentit të ndihmës ekonomike Projekti i Modernizimit të Ndhmës Ekonomike, një studim bazë¹⁹ u krye dhe krahason karakteristikat socio-ekonomike të familjeve përfituese të ndihmës ekonomike që janë rishtaz fituese dhe atyre që nuk ishin pranuar në program. Numri i kampionimit ishte 690 për familjet fituese dhe 696 për familjet jo të ligjshme në Durrës, Elbasan dhe Tiranë në 2014. Gjetjet kryesore mund të përmbliidhen në vijim:

- Të dyja grupet raportojnë përqindje të larta të të rriturve të cilët nuk punojnë (86.7 përqind për familjet fituese dhe 85.2 përqind për familjet që nuk janë fituese).
- Të ardhurat familjare mesatare nga paga janë pothuajse të njëjta ndërmjet dy grupeve (3,145 lekë dhe 3,157 lekë, respektivisht) dhe të dyja grupet gjithashtu kanë shpenzime të ngjashme familjare dhe modele shpenzimesh. Megjithatë, familjet jo përfituese kishin një mesatare dukshëm më të lartë të shpenzimeve për anëtarë të familjes.
- Të dyja grupet janë të ngjashme në aksesin e tyre ndaj shërbimeve shëndetësore: 93.2 përqind e familjeve fituese dhe 95.4 përqind e familjeve jo fituese kishin bërë një vizitë mjeksore vitin e fundit. Të dyja grupet shprehën vështirësi të konsiderueshme në mbulimin e kostove shëndetësore (94.8 përqind dhe 93.4 përqind, respektivisht).
- Familjet në të dyja grupet shprehën shqetësim rreth pagesave të shërbimeve dhe aftësisë së tyre për të plotësuar nevojat bazë. Në kuptim të disponueshmërisë së ushqimit, të dyja grupet vlerësuan nivelin e tyre të aksesit në ushqim si “shumë të papërshtatshëm” (25.4 përqind dhe 23.6 përqind, respektivisht) ose “më pak se të përshtatshëm” (52.2 përqind dhe 53.7 përqind). Kjo do të thotë që 78.3 përqind e familjeve jo fituese për programin nuk kanë akses të përshtatshëm në ushqim.
- Të dyja grupet e familjeve paraqesin modele të ngjashme në kuptim të distancave relative ndaj shërbimeve duke sugjeruar që këto dy grupe jetojnë në struktura lagjesh të ngjashme.

¹⁸ Banka Botërore (1998).

¹⁹ Jantzi (2014).

- Grupi jofitues ka një përqindje lehtësisht më të lartë të përqindjes së pronësisë së banesës (62.0 përqind) në krahasim me grupin fitues (67.4 përqind). Të dyja grupet tentonin të jetonin në banesa me numër dhomash të ngjashme (rreth 2 dhoma mesatarisht). Në kuptim të “pikëve për strehim”, familjet fituese kishin një rezultat mesatar pikësh prej 15.43 ndërkohë familjet jo fituese kishin një mesatare prej 19.19 (Rezultatet në diapazonin 12-20 janë konsideruar relativisht kushte të varfërisë strehuese).
- Të dyja familjet e ligjshme dhe jo të ligjshme tentonin të ndiqnin modele të ngjashme në kuptim të mjeteve në zotërim. Tek “rezultati i mjeteve”, rezultati mesatar për të dyja grupet ishte brenda 5-6 pikë nga 56 pikët e mundshme. Familjet jo fituese tentonin të kishin vetëm pak më shumë përqind të mjeteve në zotërim në krahasim me familjet fituese.
- Rezultati mesatar i shkallëzuar “përftimi i mirëqënies” ishte i ngjashëm ndërmjet dy grupeve (22.12 dhe 22.52 respektivisht).
- Shumica e të anketuarve në të dyja grupet nuk zotëronin ndonjë tokë ose bagëti. Familjet fituese tentonin të kishin më shumë pronarë toke dhe pak më shumë vlerë në asete bagëtitish se familjet jo fituese.

Këto gjetje konfirmojnë që ka vetëm diferenca të vogla ndërmjet familjeve të përzgjedhura dhe atyre jo të pranuar në program sipas të ardhurave, asetëve dhe aksesit në shërbime. Kjo është gjithashtu në përputhje me rezultatet e intervistave të bëra me stafin e pushtetit vendor që zbatojnë programin të cilët raportuan që ndërmjet familjeve në ngjashmëri kushtesh të njëjta, disa u përzgjodhën dhe disa të tjerë nuk u pranuan në program.

Ndryshimi kryesor është në faktin e përbërjes së anëtarëve të familjes: familjet përfituese kanë më shumë të rinj, më shumë fëmijë, dhe një nivel më të ulët arsimit, dhe familjet përfituese kanë dukshëm më pak anëtarë të moshës 50-55 në kategorinë “vështirë të gjejnë punë”. Si rezultat, familjet me kryefamiljarë femër që janë shpesh në masë më të vogël dhe familjet me një person ka më shumë të ngjarë që të përjashtohen. Sikurse u prezantua në Tabelën 3.9 më sipër, numri i familjeve përfituese ulet ndjeshëm për familjet me 4 ose më pak anëtarë sidomos ata me dy ose një anëtar. Veçanërisht shqetësim janë gjetjet që disa familje me një person të vetëm në varfëri ekstreme janë dukshëm më keq se sa përfituesit e vetëm që rezultuan të mos jenë fitues²⁰.

Përveç kësaj, ka diferenca të mëdha rajonale. Kampioni i të dhënave të familjeve në Durrës kishte rezultat më të ulët se sa dy rajonet e tjerë, por Durrësi kishte numrin më të ulët të aplikantëve dhe familjeve përfituese. Kjo mund të tregojë diferencën ndërmjet rajoneve përse i përket efektivitetit të aktiviteteve në shtrirjen dhe eliminimin e barrierave në komunikim si dhe për procesin e regjistrimit të tilla si, distanca gjeografike dhe gjuha apo niveli i analfabetizmit.

Këto gjetje sigurojnë njohuri në metodologjinë e futur rishtaz për targetim. Metoda përzgjedhëse që përdor formulën e pikëzimit të unifikuar performon mirë në minimizimin e gabimeve në përfshirje. Megjithatë, kjo metodë përjashton një numër të madh të familjeve që janë të ngjashme në varfëri në kuptim të të ardhurave dhe aftësisë të tyre për të plotësuar nevojat e tyre bazë. Peshimi i kriterëve të caktuara tenton të prodhojë gabime në përjashtim. Këto vështirësi janë të trashëguara në çdo formulë të testimit të mjeteve. Krahasuar me targetimin kategorik (psh fëmijë nën një moshë të caktuar, persona me aftësi të kufizuar), vendimet përfituese nga testet e mjeteve janë shpesh të kuptuara jo mirë nga aplikantët dhe stafi që zbaton programet²¹.

Në vështrimin e analizave paraprake të mësipërme të programit të reformuar të ndihmës ekonomike, organizatat e Kombeve të Bashkuara në Shqipëri planifikojnë të kryejnë një vlerësim të performancës së targetimit dhe formulës së pikëzimit të unifikuar brenda kuadrit të programit të përbashkët të Kombeve të Bashkuara “Opsionet e politikave strategjike për financimin e SDG”.

²⁰ Nevojitet investigim i mëtejshëm nëse këto familje me një person të vetëm marrin përfitime nga sigurimet shoqërore ose ndihma ekonomike.

²¹ Kidd et al. (2017).

Reforma e ndihmës ekonomike: pagesa e paaftësisë

Me mbështetjen nga Projekti për Modernizimin e Ndihmës Ekonomike, Ministria e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale ka ndërruar gjithashtu reformat e programit të pagesës së paaftësisë duke rishikuar kriteret e vlerësimit, procedurat e punës dhe rregullimet institucionale. Qëllimi i reformave është që të sjellë Shqipërinë në linjë me modelin biopsikosocial të ankoruar në Konventën e të Drejtave të Personave me Aftësi të Kufizuar. Megjithatë, vlerësimi i paaftësisë i përcaktuar në aktet nën ligjore²² të adaptuara së fundmi janë akoma të bazuara mbi modelin tradicional mjekësor të vlerësimit të paaftësisë. Dokumentat politikë mbi programin e reformave të paaftësisë së bashku me Planin e Veprimit për zbatimin e tij u aprovuan nga Këshilli i Ministrave në Qershor 2019. Objektivat e reformës së programit për vlerësimin e paaftësisë janë:

- Të ri-orientojnë vlerësimin e paaftësisë nga modeli i mëparshëm mjekësor në bio-psiko-social, në linjë me standartet e Organizatës Botërore të Shëndetësisë.²³ Kjo qasje funksionale do të ishte zbatuar nëpërmjet konstituimit të një komisioni multidisiplinar për paaftësinë dhe do të marrë në konsideratë ndërveprimin e kushteve shëndetësore (sëmundjeve, çrregullimeve dhe dëmtimeve) dhe faktorëve kontekstual (faktorëve mjedisorë dhe faktorëve personal) në moshë për aktivitetet e duhura ditore;
- Të fusë, së bashku me vlerësimin, procesin e përgatitjes së një plani mbështetës multidisiplinar individual për njerëzit me aftësi të kufizuar për të plotësuar nevojat e tyre mjekësore, psikologjike dhe sociale dhe të reduktojnë barrierat për përfshirjen sociale; dhe
- Të riorganizojë administratën e vlerësimit të paaftësisë për të përmirësuar eficiencën, të rrisë përgjegjshmërinë duke ndërtuar kontrollin dhe balancat, dhe reduktojë korrupsionin.

Në Prill 2017 një program pilot filloi në dy njësi administrative të Bashkisë së Tiranës. Qëllimi i projektit pilot ishte të testonte dhe demonstronte modelin e ri të vlerësimit bio-psiko-social të paaftësisë sikurse edhe skemën e re të përfitimit të propozuar. Sistemi i rivlerësimit të paaftësisë synon të vlerësojë për herë të parë nevojat individuale për punësimin, rehabilitimin dhe shërbimet e kujdesit social, arsimin dhe trainimin profesional. Kjo kërkon një mekanizëm referues transparent që ndjek në vijimësi çdo person me aftësi të kufizuar. Pak progres u arrit me zbatimin e fazës fillestare të pilotimit të sistemit të menaxhimit të informacionit për personat me aftësi të kufizuar. Aksesueshmëria e shumë shërbimeve publike është akoma një çështje kritike. Aksesin ndaj shërbimeve për personat me aftësi të kufizuar në zonat rurale është dukshëm më i ulët se për ata që jetojnë në zonat urbane dhe në veçanti për ata mbi 21 vjeç.

Në vijim të programit pilot, Vendimi i Këshillit të Ministrave Nr. 722, datë 11.11.2019 “Për përcaktimin e masës, të kriterëve, procedurave dhe dokumentacionit për vlerësimin dhe përfitimin e aftësisë së kufizuar e të ndihmës personal, dhe të strukturave përgjegjëse e të detyrave të tyre” u adaptua dhe zbatua në rajonin e Tiranës në 2019. Dy udhëzimet e reja për përcaktimin e paaftësisë tek të rinjtë dhe fëmijët u zhvilluan për të mbështetur reformën e vlerësimit të paaftësisë.

Në vijim të Vendimit të Këshillit të Ministrave Nr. 722, Protokollin Nr. 1576/1, datë 06.12.2019, “Për organizimin, të drejtat, detyrat dhe veprimet e komiteteve multidisiplinare të vlerësimit të paaftësisë” u aprovua nga Shërbimi Social Shtetëror. Megjithatë, qeveria në 2020 adaptoi Vendimin e Këshillit të Ministrave Nr. 182 “për përcaktimin e masës, të kriterëve, procedurave e dokumentacionit për vlerësimin dhe përfitimin e pagesës për personat me aftësi të kufizuara, si dhe të ndihmës personal” i cili kthen në një metodologji vlerësimi më shumë mjeksore se sa një vlerësim multi-disiplinar (shih seksionin 2.3 (2))

²² Shih Vendimin e Këshillit të Ministrave Nr. 182 “Mbi përcaktimin e masës, kriterëve, procedurave dhe dokumentacionit për vlerësimin dhe përfitimin e pagesave për personat me aftësi të kufizuar sikurse edhe për kujdestarët e tyre”.

²³ Klasifikimi Ndërkombëtar i Funkcionimit, Aftësisë së Kufizuar dhe Shëndetit është një kornizë për përshkrimin dhe organizimin e informacionit mbi funksionimin dhe aftësinë e kufizuar. Ai siguron një gjuhë standarde dhe një bazë konceptuale për përcaktimin dhe matjen e shëndetit dhe aftësisë së kufizuar.

Ndikimi i decentralizimit në dispozitat e shërbimeve të kujdesit social

Si rezultat i decentralizimit administrativ dhe fiskal, shërbimet e kujdesit social u decentralizuan nga qeveria qendrore në pushtetin vendor (61 bashki). Shpërndarja e shërbimeve të kujdesit social është nën përgjegjësinë kryesore të pushtetit vendor me mbështetjen nga institucionet e pushtetit qendror.

Vlerësimi i nevojave për shërbimet e kujdesit social u realizua në 2019 nga Shërbimi Social Shtetëror në 12 rajonet e Shqipërisë thekson që 21 bashki nuk sigurojnë ndonjë shërbim të kujdesit social, 38 bashki nuk kanë shërbime për të moshuarit dhe – 37 bashki nuk sigurojnë shërbime për personat me paafhtësi. Sipas Shërbimit Social Shtetëror, mbulimi me kujdes social është ekstremisht i ulët, me vetëm rreth 10,000 përdorues në 2019 (0.35 përqind të popullsisë). Rritja e investimeve për zhvillimin e shërbimeve të reja të kujdesit social dhe mbulimi më i madh gjeografik janë nevojë urgjente. Njësitë e pushtetit vendor pritet të vlerësojnë nevojat në territorin e tyre dhe të përgatisin planet lokale të kujdesit social, por atyre ju mungojnë burimet njerëzore dhe financiare për të realizuar këtë detyrë.

Pushteti vendor tashmë luan rolin kryesor në planifikimin dhe buxhetimin e shërbimeve të kujdesit social. Kjo kërkon sigurimin në nivelin e duhur të financimit në nivel lokal për të financuar shërbimet dhe mbikqyrjen administrative. Ndërkohë që pushteti vendor pritet të përdorë një miks të të ardhurave nga burimet lokale (taksat lokale dhe tarifet) dhe buxhetit të shtetit (grantet e kushtëzuara dhe të pakushtëzuara), kapaciteti (dhe vullnetin politik) i pushtetit vendor për të gjeneruar të ardhura të mjaftueshme dhe shpërndajë shërbime të kujdesit social ndryshon ndjeshëm. Shumë qeverisje lokale mbeten akoma shumë të varura nga buxheti i shtetit.

Me qëllim që të adresohen vështirësitë në financimin e shërbimeve të kujdesit social, u krijua në 2018 Fondi Social. Fondi Social siguron në vitin e parë mbështetje financiare për të mbështetur deri në 90 përqind të financimit, në vitin e dytë deri në 60 përqind të financimit, dhe më vonë 30 përqind të financimit.

Planet kanë nevojë të vlerësojnë kostot e përgjithshme për shërbimet dhe pjesën që mund të mbulohej nga buxheti i bashkisë. Në këtë kontekst, shumica e bashkive të vendit, me mbështetjen e partnerëve ndërkombëtarë, kryesisht të organizatave të Kombeve të Bashkuara, kanë draftuar Planet për Kujdesin Social. Këto plane, megjithëse kanë autorë nga stafi lokal dhe kanë pronësinë lokale, përsëri kanë vështirësi në zbatim. Vështirësitë kryesore kanë të bëjnë me financimin, kapacitetet lokale për të siguruar shërbimet e kujdesit social (profesionalizmi i punonjësve të kujdesit social), dhe çështje që kanë të bëjnë me prokurimet dhe kontraktimin nga jashtë institucionit. Vetëm 2 bashki kanë deri më tani, aprovuar dhe buxhetuar planet e kujdesit social duke përvijuar nevojat e komuniteteve në vështirësi dhe shërbimet që nevojiten të ngrihen për t'ju përgjigjur këtyre nevojave. Megjithëse 14 nga ato janë aprovuar nga Shërbimi Social Shtetëror, Fondi Social nuk ka disbursuar ndonjë fond akoma.

OJF në Shqipëri luajnë një rol të rëndësishëm në masat e shërbimeve të kujdesit social por ato gjithashtu hasin sfida në mbulim, sigurimin e cilësisë dhe qëndrueshmërinë e shërbimeve. Nën dritën e mungesës së shërbimeve të kujdesit social të përshkruara më sipër, ka një nevojë urgjente për qeveritë të rrisin furnizimin e shërbimeve. Për të bërë këtë, është e rëndësishme për qeverisjet lokale të jenë në gjendje të tërheqin kapacitetet ekzistuese të OJF të cilat sigurojnë shërbime cilësore të përshtatshme. Për këtë arsye, nevojitet të rishikohen rregullat aktuale për prokurimin publik, që tju bëjë të mundur OJF-ve të marrin pjesë në tenderat publikë për shërbimet e kujdesit social të parashikuara.

Në përpjekjet e saj drejt hyrjes në BE, Shqipërisë i kërkohet gjithashtu të zhvillojë një kuadër financiar që mundëson qeverisjen vendore të ndërtojë dhe financojë shërbimet e kujdesit social dhe të forcojë sistemin e mbrojtjes sociale në nivel lokal. Veçanërisht, Instrumenti i Ndihmës së Para Aderimit të BE (IPA) synon në përmirësimin e aksesueshmërisë dhe cilësisë së shërbimeve të integruara të kujdesit social në nivel lokal, duke përfshirë nëpërmjet shtjellimit të kuadreve rregullatore dhe financiare përkatëse sikurse edhe sistemet e shpërndarjes dhe administrative të tilla si ndërtimi i standarteve të shërbimeve,

Rregjistri Kombëtar Elektronik të Shërbimeve të Kujdesit Social dhe Njësitë e Vlerësimit të Nevojave dhe Rreferimit.

5. Ndikimi i COVID-19: një vlerësim paraprak

Ndikimi ekonomik i COVID-19

Për shkak të krizës së COVID-19, nivelet e papunësisë pritet të rriten përsëri. Ndërkohë që në Maj 2020, vetëm 11 përqind e firmave raportuan pushime nga puna, kjo shifër pritet të rritet në 45.1 përqind të punonjësve që janë të punësuar në firmat të cilat ishin ose në mbyllje të plotë (30.4 përqind) ose në sektorë me kërkesë më të ulët (14.7 përqind) me një vlerësim prej 457 milion Euro të pagave në rrezik. Turizmi, tekstili dhe sektori ushqimor janë më të prekurit (Banka Botërore 2020a).

Pandemia COVID-19 është duke pasur një ndikim të egër mbi ekonominë. Vetëm 61 përqind e firmave janë vlerësuar që do të mbeten me fitim (duke presupozuar që masat e mbylljes do të jenë të kufizuara deri në tre muaj në 2020). Të ardhurat nga taksat e korporatave janë llogaritur të bien me 35 përqind dhe firmat priten të akumulojnë humbje ekuivalente me 1.5 përqind të PBB (Banka Botërore 2020b).

Tabela 5.1 prezanton parashikimin e vlerave të indikatorëve kryesorë makroekonomik të bazuar në parashikimet më të fundit të mundshme të FMN-s. Përsa i përket efekteve të paketave stimuluese në tremujorin e dytë të 2020, këto parashikime shikojnë një rigjenerim relativisht të shpejtë nga goditja në 2020 me një rritje modeste dhe stabilizim në papunësi në të gjitha vëndet. Megjithatë, kufizime shtesë të lëvizjes dhe dëmshpërblime të tjera që nga Vera 2020 mund të afektojnë nivelin e aktivitetit ekonomik dhe shtyrjen e rigjenerimit.

Tabela 5.2 tregon rezultate të parashikimeve ekonomike nga Komisioni Europian për Shqipërinë. Këto vlerësime tregojnë një panoramë më pak optimiste të krahasuar me parashikimet e FMN-s më sipër.

► Tabela 5.1. Parashikimi i FMN për indikatorët kryesorë makroekonomike, Shqipëria, 2019-2025.

	Rritja reale PBB (%)	CPI (% në fund të vitit)	Niveli papunësisë (%)	Huamarrja/huadhënia e përgjithshme e qeverisë (% ndaj PBB)	Borxhi bruto i përgjithshëm i qeverisë (% ndaj PBB)
2019	2.2	1.1	11.5	-2.0	67.7
2020	-7.5	1.2	11.8	-8.4	83.3
2021	6.1	2.2	11.5	-4.7	83.2
2022	5.8	2.5	11.3	-2.6	77.1
2023	4.3	2.9	11.0	-2.0	74.8
2024	3.5	3.0	11.0	-2.0	71.9
2025	3.4	3.0	11.0	-2.0	69.1

Burimi: FMN. World Economic Outlook and Fiscal Monitor (October 2020). <https://www.imf.org/external/datamapper/profile>.

► **Tabela 5.2. Parashikimi ekonomik i Komisionit European, Shqipëria, 2019-2022**

	PPB	Konkurrenca private	Konsumi publik	Rritja punësim	Niveli i papunësisë	Bilanci i përgjithshëm i qeverisë	Borxhi bruto i përgjithshëm i qeverisë
2019	2.2	3.3	3.8	0.8	12.2	-1.8	66.3
2020	-6.8	-4.4	4.0	-2.7	14.5	-6.3	78.8
2021	3.7	2.8	4.2	1.0	13.9	-5.3	77.4
2022	4.6	3.3	2.9	2.0	12.8	-3.2	75.4

Burimi: Komisioni European, Drejtoria e Përgjithshme për Çështjet Ekonomike dhe Financiare.

Reagimi i mbrojtjes sociale ndaj pandemisë së COVID-19

Në përgjigje të pandemisë së COVID-19, Shqipëria ka ndërmarrë një seri masash për të zbutur ndikimin negative të krizës. Tabela 5.3 përmbledh masat e ndërmarra gjatë bllokimit të parë në tremujorin e dytë të 2020. Paketa stimuluese totale është të paktën 2.9 përqind e PBB. Informacion më i detajuar prezantohet në Aneks.

Ndërhyrjet kryesore përfshijnë:

- Subvencionimin e pagës minimale dhe një ndihmë financiare një herëshe për punonjësit e prekur nga pandemia;
- Indeksi i pensioneve me 2.3 përqind;
- Dyfishimin e masës së pagesës së papunësisë dhe të ndihmës ekonomike;
- Ndihmë financiare një herëshe për familjet me të ardhura të ulta që nuk merrnin ndihmë ekonomike;
- Shtyrje të taksave dhe pagesave të tjera (nuk përfshihen kontributet e sigurimeve shoqërore);
- Masa për huatë dhe garanci për ndërmarrjet;
- Masa për përfitime në natyrë dhe shërbime të tjera.

Masat për mbrojtjen sociale përbënin një nga pjesët më thelbësore të përgjigjeve ndaj krizës së COVID-19 gjatë fazës së parë të pandemisë. Megjithatë, kriza ka zbuluar hendeqe në sistemin ekzistues të sigurimit social që buruan nga çështje të trashëguara në botën aktuale të punës.

Në veçanti, kriza e COVID-19 ka risjellë nevojën urgjente për të zgjeruar sistemin e sigurimit social për të mbuluar punonjësit në të gjitha llojet e punësimit dhe duke marrë në konsideratë heterogjinitetin e tyre të madh dhe lëvizjen e shpeshtë, dhe duke përmirësuar mbledhjen dhe detyrimin e ulët të kontributeve nëpërmjet inkurajimit të formalizimit.

Pavarësisht rritjes së dyshimtë të punësimit dhe zgjerimit të pabarazisë, kriza paraqiti nevojën për të konsideruar përshtatjen e arkitekturës ekzistuese të sigurimit social dhe kërkimit për një përzjerje më të përshtatshme të sistemeve kontributive dhe jo-kontributive që sigurojnë një nivel të sigurimit me të ardhura bazë me vëmendjen e duhur ndaj mekanizmave financues më të qëndrueshëm afat gjatë.

Lufta globale ndaj coronavirusit të ri COVID-19 është akoma larg përfundimit. Për rrjedhojë mbeten akoma pasiguri të mëdha përpara. Në këtë mënyrë situata kërkon një monitorim të afërt. Kriza e COVID-19 ka theksuar rëndësinë e investimeve proaktive për të ndërtuar sisteme bashkëkohore dhe

elastike të sigurimit social që mund t’ju përgjigjen shpejt dhe në mënyrë efektive goditjeve kur shfaqen. Ajo ka theksuar gjithashtu rolin kritik të ndërhyrjeve të Shtetit në ballafaqimin me një ngjarje emergjente të paparashkuar.

► **Tabela 5.3. Reagimet e mbrojtjes sociale dhe vendeve të punës ndaj COVID-19, Tremujori dytë i 2020**

Sigurimi Social	Pensionet	Pensionet u indeksuan me 2.3 përqind. Kufizime të reja u vunë. U paguan kompensime për pensionet e ulëta.
	Pagesa e papunësisë	Pagesa e papunësisë u rrit me dy herë gjatë pandemisë së COVID-19.
	Kontributet e sigurimeve shoqërore	Nuk pati shtyrje për pagesat e kontributeve të sigurimeve shoqërore.
Ndihma Ekonomike	Transfertat e rregullta në para	Masa e Ndhmës Ekonomike u rrit me dyfishin.
	Pagesë në para një-herëshe	Ndihmë financiare prej 16,000 lekë për person për të gjithë aplikantët e ndihmës ekonomike që nga Korriku 2019, të cilët nuk kishin marrë ndonjë ndihmë ekonomike deri në Prill 2020 dhe nuk përfitonin nga fondet prej 6 përqind të bashkive.
	Përfitim në strehim, kupon ushqimor, të tjera	Përgjegjësi shtesë për institucionet qeveritare për të siguruar shpërndarjen në shtëpi të ndihmës për personat në nevojë. Kjo ndihmë konsistonte në shpërndarjen e sigurimit social mujor ose përfitime të ndihmës ekonomike sikurse edhe produkte, ushqime dhe artikuj jo ushqimor, dhe medikamenteve.
	Ushqim në shkollë	Universitetet, shkollat dhe kopshtet u mbyllën. Një diapason i kurseve për nxënësit e fillores dhe nëntëvjeçares u zhvilluan dhe transmetuan në kanalet kombëtare TV. Mësimi në distancë gjithashtu është i mundshëm nëpërmjet platformave online në nivel shkolle. Leksionet online vijuan deri në fund të Majit.
	Punë publike	Bashkia e Tiranës filloi një program për të shpërndarë ushqim për të moshuarit të cilët nuk jetonin me anëtarët e familjes.
	Anullim pagesash	Proçedura të relaksuara dhe përjashtuese për matjen e energjisë së konsumuar gjatë emergjencës së COVID-19. Pagesa e qerasë për Prillin dhe Majin 2020 mund të shtyhet për pas Majit 2020.
	Tregu i Punës	Rregullimet në Tregun e Punës
Reduktimi kohës së punës/ përdorimi lejeve		Puna me kohë të pjesshme (kohë të pjesshme ose javore) lejohet me Kod Pune në Shqipëri dhe ka të njëjtat të drejta sikurse punonjësi me kohë të plotë.
Subvencionimi i pagës		Subvencionimi i pagës minimale me 26,000 lekë (paketa e parë, gjatë mbylljes) dhe një ndihmë financiare një-herëshe 40,000 lekë (paketa e dytë, një-herëshe) u siguruan për punonjësit e kompanive të cilat kishin pezulluar aktivitetin e tyre për shkak të rregullimeve, punonjësit e mëparshëm të kompanive të cilat u lejuan të punojnë por që ishin pushuar nga puna dhe punonjësit e kompanive me xhiro më pak se 14 milion lekë të cilat kishin qenë duke punuar para pandemisë.

Burimi: ILO. (2021). Vlerësimi i reagimit të Sigurimit Social ndaj COVID-19.

6. Konkluzione

Sistemet e mbrojtjes sociale në Shqipëri, përbëhen nga skemat kontributive të sigurimit social, programet e ndihmës sociale dhe shërbimet e kujdesit social të financuara nga taksat, janë thelbësore në sigurimin e mbrojtjes së shëndetit dhe të ardhurave për reduktimin e varfërisë për të gjithë Shqiptarët përgjatë të gjithë ciklit të jetës. Zhvillimi i sistemit të mbrojtjes sociale në Shqipëri është mbështetur nga ratifikimi i Konventës së Standarteve Minimale të Sigurimit Social të ILO, Nr. 102 në 2006. Sistemi ekzistues, megjithatë, nuk siguron mbulim me përfitime bashkëkohore. Ashtu sikurse është theksuar shpesh, Shqipëria nuk ka përfitime në para për fëmijë apo shërbime bashkëkohore afat gjata për të moshuarit, dhe ekzistojnë hendeqe në mbulim si për skemat kontributive ashtu edhe për ato jo kontributive.

Sistemi Shqiptar i mbrojtjes sociale karakterizohet nga një masë krahasimisht e ulët e nivelit të shpenzimeve. Në 2017, Shqipëria shpenzoi vetëm 9.2 përqind të PBB për mbrojtjen sociale (duke përfshirë sigurimin shëndetësor), çka ishte me pak se gjysma e mesatares së BE dhe dukshëm nën vendet fqinje që aspirojnë BE. Kjo reflekton mbulimin e ulët të përfituesve (me përjashtim të pensioneve për të moshuarit) dhe nivele të ulëta të përfitimit.

Duke falënderuar Shtetin për mbulimin e kontributit të sigurimit shëndetësor për popullsinë që nuk punon, , pothuajse e gjithë popullsia në Shqipëri ka akses në shërbimet e kujdesit shëndetësor. Megjithatë shpenzimi në total i Fondit të Sigurimit Shëndetësor ishte mjaft i ulët në 2.6 përqind të PBB, në 2018. Kjo ngre shqetësimin nëse siguri aktual siguron mbrojtjen e përshtatshme të mbrojtjes financiare për individët dhe familjet sidomos për grupet me të ardhura të ulëta. Investimi në shërbimet sociale është veçanërisht i ulët.

Falënderit kryesisht për mbështetjen e Shtetit për të siguruar mbulimin e sigurimeve shëndetësore për subvencionet e popullatave që nuk punojnë. Në mirënjohje të subvencionimit të gjerë të Shtetit, pothuajse e gjithë popullsia në Shqipëri ka akses në shërbimet e kujdesit shëndetësor. Në 2016-2017, Shqipëria shpenzoi 6.7 përqind të PBB për shëndetësinë. Megjithatë, shpenzimi total i Fondit të Sigurimit Shëndetësor ishte mjaft i ulët në 2.6 përqind të PBB në 2018. Ndërkohë që niveli i shpenzimeve shëndetësore është i krahasueshëm me vendet e tjera, Shqipëria paraqet një pjesë të zgjeruar të pagesave nga xhepi në 58.0 përqind. Kjo ngre shqetësimin nëse sistemi aktual siguron mbrojtjen e duhur financiare të kostove për kujdes shëndetësor për individët dhe familjet sidomos të atyre grupeve me të ardhura të ulëta.

Nevoja për mbrojtje sociale të zgjeruar

Sipas degëve të përfitimit, pensionet kontributive për të moshuarit qëndrojnë në kuptimin e mbulimit të përfituesve dhe shpenzimeve. Aktualisht, pothuajse të gjithë personat e moshuar (duke përfshirë të gjithë popullsinë 70 vjeç e sipër) marrin pensione pleqërie. Megjithatë niveli i përfitimit është modest (shumë afër me standartet minimale), pensionet e pleqërisë dhe familjes kanë ndikimin më të rëndësishëm në reduktimin e varfërisë sidomos ndërmjet të moshuarve. Shpenzimet për pensionet e të moshuarve në Shqipëri janë të krahasueshme me vendet fqinje dhe llogariten për pothuaj 70 përqind të shpenzimeve totale të mbrojtjes sociale.

Përveç pensioneve të pleqërisë, përfitimet e tjera për mbrojtjen sociale në para, si ato kontributive ashtu edhe ato jo kontributive, tregojnë performancë të dukshme të varfër në kuptim të mbulimit të përfituesve dhe mjaftueshmërisë së përfitimit. Një arsye për këtë është që një numër i madh i punonjësve nuk kualifikohen për përfitime të sigurimeve shoqërore për shkak se ata nuk kanë paguar kontributet për periudhën e kërkuar. Klientët kryesorë të sigurimit social aktual janë punonjësit në ekonominë formale. Një numër në rritje i punonjësve në ekonominë informale dhe në format jo standarte të punësimit,

që nuk janë të mbuluara në mënyrën e përshtatshme nga sistemi ekzistues. Për pasojë, ata të cilët kanë dështuar të kualifikohen si përfitues të sigurimit shoqëror kërkojnë të marrin ndihmë ekonomike. Kjo është tipike për rastet e përfitimit të paaftësisë dhe aksidenteve në punë.

Nga ana tjetër, sistemi i mbrojtjes sociale, në veçanti programi i ndihmës ekonomike, vuan nga mbulimi i ulët, ndoshta për shkak të gabimeve në përjashtim që rezultojnë nga mekanizmi i shënjestrimit dhe nivelet shumë të ulëta të përfitimit. Në këtë mënyrë nuk siguron tërësisht mbrojtje të të ardhurave bazë për popullsinë në nevojë për ndihmë. Shpenzimet për ndihmën ekonomike kanë qenë rreth 0.3 përqind të PBB. Reforma e para pak kohëve për ndihmë ekonomike, që synonte të përmirësonte saktësinë në shënjestrim, rezultoi në një rënie të shpejtë të numrit të përfituesve dhe një reduktim të mëtejshëm të shpenzimeve në 0.2 përqind të PBB në 2019.

Mbulimi me kujdes social është ekstremisht i ulët, me vetëm rreth 10,000 përdorues në 2019 (0.35 përqind të popullsisë). Shërbimet e Kujdesit Social nuk janë të mundshme në 27 nga 61 bashkitë dhe nuk ka funksionim të sistemit referues. Aty ku shërbimet e kujdesit social ekzistojnë, ato janë shpesh të nën financuara dhe me cilësi të dobët. Decentralizimi i fundit i shërbimeve të kujdesit social drejt qeverisjes vendore nuk përputhet me investimet përkatëse në ndërtimin e kapaciteteve lokale për të kryer këtë përgjegjësi të re. Shqipëria ka bërë zotim të prerë dhe progres të fortë në ndërtimin e një kuadri rregullator modern për përfitimin nga paaftësia dhe shërbimet e kujdesit social por përpjekje të mëtejshme nevojiten për ti kthyer këto aspirata në realitet.

Sigurimi i burimeve të qëndrueshme për mbrojtjen sociale

Reforma e pensioneve e vitit 2015 i ngushtoi kushtet për të drejtat duke përfshirë rritjen graduale në moshën e pensionimit. Kjo kontribuoi në përmirësimin e qëndrueshmërisë financiare megjithëse niveli i kontributit aktual është i pamjaftueshëm dhe Fondi ka qenë në mënyrë të vazhdueshme në deficit në nivelet midis 1.5 dhe 2 përqind të PBB. Nëse pjesëmarrja e ulët në sistemin e sigurimit shoqëror do të vazhdojë, - vetëm 44.5 përqind e popullsisë në moshë pune 20 – 64 vjeç në Shqipëri kontribuon në Sistemin e Sigurimit Shoqëror në 2019 - , atëherë kostot e pensioneve të pleqërisë do të kalojnë nga sistemi kontributiv në pensionet sociale. Nën deklarami i pagave e përkeqëson akoma më tej problemin. Një rol në rënie i sistemit të sigurimit shoqëror kontributiv do ta bëjnë atë politikisht dhe nga pikëpamja sociale të paqëndrueshëm në planin afatgjatë.

Për sistemin ekzistues kontributiv të sigurimeve shoqërore që të veprojnë si një sigures kryesor i sigurimit të të ardhurave për të moshuarit dhe të sigurojë mbrojtjen me të ardhura për një grup më të gjerë punonjësish, kërkohen përpjekje serioze politike për të zgjeruar mbulimin e punonjësve dhe në përputhje me pagesat e kontributeve. Ka një nevojë urgjente për të rritur pjesëmarrjen e forcës së punës dhe formalizimin e punësimit, për të rritur mbulimin efektiv të të gjitha llojeve të kontratave të punësimit, dhe për të rritur zbatimin dhe pajtueshmërinë me raportimin e aktiviteteve ekonomike dhe pagesës së kontributeve.

Ekonomia informale dhe puna e padeklaruar janë probleme me rrënjë të thella dhe përbëjnë pengesa kryesore në zgjerimin e mbulimit të sigurimit social. Politikat inkurajuese për tranzicionin drejt formalitetit dhe reduktimit të punës së padeklaruar kërkojnë angazhime afat gjata dhe përpjekje të vazhdueshme të të gjithë aktorëve.

Sistemi i sigurimit shoqëror duhet të mbrojë në mënyrë efektive të varfërit dhe grupet vulnerable si rrjet i sigurisë sociale, duke përfshirë shërbimet sociale. Një pyetje kyç është se si duhet të projektohet dhe zbatohet një sistem ndihme sociale efektive dhe të krijojë hapësirën fiskale të domosdoshme për të financuar përfitimet në një mënyrë të qëndrueshme. Fondi Social u ndërtua si një mekanizëm i përkohshëm për të siguruar financimin fillestar për qeverisjen lokale në afat shkurtër. Megjithatë, Shqipëria ka nevojë të zhvillojë një strategji financimi që siguron investime të rritura, të qëndrueshme në sistemin e mbrojtjes sociale në nivelet e duhura të krahasueshme me shtetet anëtare të BE-s.

Drejt një sistemi të duhur, të barabartë dhe të qëndrueshëm të mbrojtjes sociale

Rekomandimi Nr. 202 i ILO-s për Dysshemetë e Mbrojtjes Sociale ju kërkon Shteteve Anëtare të ILO dhe partnerëve socialë të ndërtojnë dhe mirëmbajnë dysshemetë e sigurimit social, të cilat do të sigurojnë akses në kujdesin shëndetësor themelor dhe sigurim të ardhurash bazë për të gjithë. Në të njëjtën kohë, Rekomandimi Nr. 202 kërkon që në mënyrë të vazhdueshme të sigurohen nivele më të larta të sigurimit social për sa më shumë njerëz që të jetë e mundur, të drejtuara nga Konventa Nr. 102 për Standartet Minimale të Sigurimit Social dhe instrumentat e tjerë të sigurimit social të ILO-s.

Në këndvështrimin e ndryshimeve në të ardhmen, sikurse edhe nga këndvështrimi i vështirësive në burime, aktorët kryesorë duhet të diskutojnë një diapason të gjerë të opsioneve politike dhe të marrin vendime racionale për të ndërtuar një sistem të duhur të mbrojtjes sociale, të barabartë dhe të qëndrueshëm për të mos lënë askënd pas. Për të informuar këtë debat, ILO, me financimin nga Programi i Përbashkët "Përshpejtimin e Mbrojtjes Sociale në Nivel Vendor", prodhoi një raport të titulluar "Hapësira fiskale për financimin e mbrojtjes sociale në Shqipëri" për të plotësuar shqyrtimin aktual të sistemit të mbrojtjes sociale në Shqipëri.

Për të përmbushur këtë synim, ILO sëbashku me organizatat partnere të Kombeve të Bashkuara, qëndrojnë gati për të siguruar asistencë teknike të mëtejshme në vijim të gjetjeve dhe rekomandimeve të bëra në këtë raport.

Referencat

ILO. 2021. Assessment of the Social Security Responses to COVID-19: Lessons from the Western Balkans and Eastern Europe during the first stage of the pandemic.

ILO. 2021. Fiscal space for financing social protection in Albania.

Institute of Statistics, Methodological and theoretical concepts of poverty in Albania.

Jantzi, T. 2014. Impact Evaluation Baseline Report, Albania Ndhma Ekonomike, Social Assistance Modernization Project, Official Final Version, mimeographed notes.

Kidd, S. et al. 2017. Exclusion by design: An assessment of the effectiveness of the proxy means test poverty targeting mechanism, ESS – Working Paper No. 56, ILO, Geneva.

United Nations. 2014. A review of the disability assessment system in Albania. United Nations support to social inclusion in Albania Programme.

World Bank. 1998. Social assistance in Albania: decentralization and targeted transfers. Washington, D.C.

World Bank. 2010a. Social Assistance Policy Note: Key Challenges and Opportunities.

World Bank. 2010b. Albania: Pension Policy Challenges in 2020 (note prepared under the World Bank's Advisory Services and Analytics activity for Western Balkans Pensions).

World Bank. 2020a. Western Balkans Regular Economic Report. The Economic and Social Impact of COVID-19. No. 17.

World Bank. 2020b. Macroeconomic Trade and Investment Practice Notes. The Impact of COVID-19 on Formal Firms: Evidence from Albania.

Ymeri, S. 2019. ESPN Thematic Report on financing social protection: Albania, European Social Policy Network.

Websites

Ministria e Financave dhe Ekonomisë:	http://www.financa.gov.al
Instituti i Sigurimeve Shoqërore:	http://www.issh.gov.al
Fondi Kombëtar i Sigurimeve Shëndetësore:	https://www.fsdksh.com.al
Shërbimi Kombëtar i Punësimit:	http://www.kerkojpune.gov.al
Drejtoria e Përgjithshme e Tatimeve:	https://www.tatime.gov.al
Instituti i Statistikave:	http://www.instat.gov.al

Aneks. Mbrojtja sociale dhe vendet e punës në reagim ndaj COVID-19

Situata COVID-19	Në 8 Mars u konfirmuan rastet e para. Në 10 Mars hyri ne fuqi politika e mbylljes. Në 1 Qershor, faza e dytë e rihapjes.	
Sigurimi Social	Pensionet	Në 30.3.2020, Dekreti "Mbi indeksimin e pensioneve" kreu 2.3 përqind në pensione, duke ngritur limite të reja, plus kompensimet për pensionet e ulta.
	Pagesa e Papunësisë	Vendimi i Këshillit të Ministrave Nr. 254, datë 27.3.2020 (i ndryshuar), "Mbi procedurat për mbështetjen financiare të punonjësve të bizneseve me xhiro deri në 14 milion lekë, mbështetjen ekonomike dhe pagesës së papunësisë për shkak të COVID-19" (paketa e parë financiare) rriti pagesës e papunësisë me dy herë gjatë pandemisë së COVID-19.
	Kontributet e Sigurimeve Shoqërore	Nuk kishte shtyrje të pagesave për kontributet e sigurimeve shoqërore.
Ndihma Ekonomike	Transfertat e rregullta në para	Përfitimet nga Ndihma Ekonomike u dyfishuan.
	Pagesë në para një-herëshe	Vendimi i Këshillit të Ministrave Nr. 13, datë 22.4.2020, "Për disa shtesa dhe ndryshime në vendimin nr.305, datë 16.4.2020, të këshillit të ministrave, "Për përcaktimin e procedurave, të dokumentacionit dhe të masës së përfitimit të ndihmës financiare për të punësuarit aktualë dhe punonjësit e larguar nga puna si pasojë e COVID-19". Ky vendim mbështet me ndihmë financiare prej 16,000 lekë për person për të gjithë aplikantët e ndihmës ekonomike që nga Korriku 2019, të cilët nuk kishin marrë asnjë ndihmë ekonomike deri në Prill 2020 dhe nuk përfitonin as nga fondet 6% të bashkive.
	Përfitim Strehimi, Kuponi Ushqimor, etj	Vendimi i Këshillit të Ministrave Nr 236, datë 19.3.2020, "Për marrjen e masave për ofrimin e asistencës në banesë ndaj shtresave në nevojë, në kushtet e epidemisë së shkaktuar nga covid-19" krijon përgjegjësi shtesë të institucioneve qeveritare për të siguruar shpërndarjen në shtëpi të ndihmës për personat në nevojë. Kjo ndihmë konsiston në shpërndarjen e sigurimit shoqëror mujor dhe përfitimeve nga ndihma ekonomike sikurse edhe produkte, artikuj ushqimorë dhe jo-ushqimorë, dhe medikamente. Personat në nevojë janë: - Familjet ose individët që marrin ndihmë ekonomike; - Individët me aftësi të kufizuar; - Pensionistët (Të moshuarit); - Personat e pastrehë ose që kanë humbur shtëpitë e tyre nga tërmeti.
	Shkollimi	Universitetet, shkollat dhe kopshtet u mbyllën. Një gamë kursesh televizive u zhvilluan për nxënësit e shkollave fillore dhe nëntë vjeçare. Mësimi në distancë u bë i mundur gjithashtu nëpërmjet platformave online në nivel shkollë. Leksione online vijuan deri në fund të Majit.
	Punët Publike	Bashkia e Tiranës krijoi një inisiativë Adapto një Gjysh/Gjyshe për ti ndihmuar në shpërndarjen e ushqimit për të moshuarit që jetonin vetëm.
	Shtyrje Pagesash	Vendimi i Këshillit të Ministrave Nr. 58, datë 26.3.2020, "Për Entin Rregullator të Energjisë" siguron procedura të relaksuara dhe përjashtuese në matjen e konsumit të energjisë elektrike gjatë emergjencës së COVID-19. Akti Normativ Nr. 3, datë 15.3.2020, "Mbi masat speciale administrative gjatë periudhës së infeksionit të COVID-19" siguroi që qirramarësit të cilët kanë pezulluar kontratën e qerasë për shkak të pandemisë mund të shtyjnë pagesën e qerasë për Prill dhe Maj 2020. Kjo aplikohet gjithashtu për studentët dhe bizneset që kanë xhiro më të ulët se 14 milion lekë të cilët e kanë pezulluar aktivitetin e tyre për shkak të situatës. Pagesa do të bëhet pas Majit 2020 ndërkohë që për ata të cilët kontrata përfundon para 31 Majit 2020, detyrimi do bëhet për deri në tre muaj pas kësaj date.

Tregu i Punës	Rregullime në Tregun e Punës	Qeveria lejoi disa biznese të mbeten të hapura pas deklarimit të OBSH për pandeminë dhe mbylli disa të tjera. Disa aktivitete u lejuan të punojnë madje edhe pas Prillit. Në 1 Qershor shumica e aktiviteteve u lejuan të rihapen, ndonëse me masa të shtuara. Megjithatë, transporti publik nuk u lejua deri në 5 Korrik.
	Reduktimi kohës punës / përdorimi lejeve	Puna me kohë të pjesshme (kohë të pjesshme ose me javë) u lejua sipas Kodit të Punës së Shqipërisë dhe gëzon të njëjtat të drejta sikurse edhe punonjësit me kohë të plotë.
	Subvencionimi pagave	<p>Vendimi i Këshillit të Ministrave Nr. 254, datë 27.3.2020 (i ndryshuar), "Për përcaktimin e procedurave, të dokumentacionit dhe të masës së përfitimit të ndihmës financiare për të punësuarit në subjektet e biznesit me të ardhura vjetore deri 14 milionë lekë, ndihmës ekonomike e të pagesës të së ardhurës nga papunësia gjatë periudhës së fatkeqësisë natyrore, të shpallur si pasojë e covid-19" (paketa e parë financiare) mbështet:</p> <ul style="list-style-type: none"> - Bizneset me një xhiro vjetore deri 14 milion lekë, të mbyllura si rezultat i kufizimeve të imponuara mbi bizneset (mbyllja); - Të gjithë punonjësit në këto biznese që marrin një pagë të barabartë me pagën minimale (26,000 lekë) përgjatë periudhës së kufizimeve; - Individët me të ardhura personale vjetore mbi 2 milion lekë nuk kanë të drejtë të marrin një mbështetje të tillë. <p>Vendimi i Këshillit të Ministrave Nr. 305, date 16.4.2020, "për përcaktimin e procedurave, të dokumentacionit dhe të masës së përfitimit të ndihmës financiare për të punësuarit aktualë dhe punonjësit e larguar nga puna si pasojë e COVID-19" (paketa e dytë financiare) mbështet:</p> <ul style="list-style-type: none"> - Pagesën njëherëshe prej 40,000 lekë për të gjithë punonjësit (të punësuar formalisht ndërkohë) në ndërrmarjet me një xhiro deri në 14 milion lekë, të lejuara që të punojnë nga kufizimet e qeverisë, me përjashtim të aktiviteteve të caktuara (juristët, noterët, industria e ushqimit, farmaceutika, etj.); - Pagesë njëherëshe prej 40,000 lekë për të gjithë punonjësit (të punësuar formalisht ndërkohë) në të gjitha strukturat akomoduese aktive në fillim të emergjencës. <p>Vendimi i Këshillit të Ministrave Nr 13, datë 22.4.2020, "Për disa shtesa dhe ndryshime në vendimin nr.305, datë 16.4.2020, të Këshillit të Ministrave, "Për përcaktimin e procedurave, të dokumentacionit dhe të masës së përfitimit të ndihmës financiare për të punësuarit aktualë dhe punonjësit e larguar nga puna si pasojë e covid-19". Ky vendim mbështet me:</p> <p>Pagesë njëherëshe në masën prej 40,000 lekë për të gjithë punonjësit e Rafinerisë së Ballshit.</p> <p>Punonjësit e administratës shtetërore të cilët janë anëtarë bordi ose anëtarë të komisioneve të institucioneve të administratës publike, institucioneve të arsimit të lartë dhe kompanive të cilat janë pronësi e shtetit me më shumë se 50% nuk marrin pagesë mujore nga 1 Prilli deri në fund të pandemisë. Përjashtim bëhet për punonjësit të cilët janë anëtarë bordi, komisioneve ose institucioneve të cilat i përkasin Ministrisë së Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale. Kryeministri, Zv. Kryeministri dhe ministrat për periudhën e pandemisë do të marrin 50% të pagës së tyre aktuale.</p>

Implikimet Fiskale	Shpenzime shtesë në sektorin shëndetësor	Shpenzime shtesë: financime shtesë për sektorin shëndetësor prej 2.5 miliard lekë (0.2% e PBB). Përveç alokimit nga Fondi Rezervë (0.5 miliard lekë).
	Shpenzime shtesë në sektorin jo-shëndetësor	<p>Shpenzime shtesë:</p> <ul style="list-style-type: none"> Sasitë e pagesës së papunësisë dhe ndihmës ekonomike u dyfishuan. Mbështetja për bizneset e vogla dhe të vetë-punësuarit që janë të detyruar të mbyllin aktivitetet për shkak të pandemisë (një pagë minimale prej 26,000 lekë në muaj), dhe personat në bizneset familjare (me anëtarët e deklaruar port të papaguar të familjes në listë pagesat, për deri në dyfishin e pagës minimale). Këto masa vazhduan për Prill deri Qershor. Transferta një-herëshe prej 40,000 lekë për personat e prekur (në turizëm, përpunim aktive dhe punonjësit e bizneseve të vogla që nuk ishin përfshirë në paketën e parë, duke përfshirë punonjësit e bizneseve të mëdha që kanë bërë pushime për shkak të pandemisë. <p>Të ardhura të shkuara në kohë:</p> <ul style="list-style-type: none"> Bizneset e vogla (ato me një xhiro vjetore nën kufirin e 14 milion lekëve) nuk do të paguajnë taksën e fitimit në 2020 (Akti normativ Prill 23). Shuma e vlerësuar 81 milion lekë. <p>Në total: 1.1% e PBB</p>
Implikimet fiskale (Vazhdim)	Shpenzime të përshpejtuara dhe të ardhura të shtyra	<p>Shtyrje pagesash:</p> <ul style="list-style-type: none"> Të gjitha kompanitë e mëdha (me përjashtim të bankave, telekomunikacionit, ndërmarrjeve shtetërore dhe kompanive të zinxhirit të furnizimit me mallrat e domosdoshme) mund të shtyjnë pagesat e taksave korporative mbi të ardhurat për T2 dhe T3-të të 2020 në T2 - T3 të 2021. Për turizmin, përpunimin aktiv dhe call centers - dhe bizneset e vogla me xhiro 14 milion ose më pak - pagesa e T2, T3 dhe T4 të 2020 për taksën mbi fitimin shtyhet për T2-T4 të 2021.
	Detyrimet me kusht: Garancitë (për huatë, depozitat etj.) dhe veprimet gjysëm fiskale	<ul style="list-style-type: none"> Garancia sovrane prej 11 miliardë lekë për bizneset e mëdha për të ndihmuar linjat e kredisë në sektorin bankar si dhe për të paguar pagat e punonjësve. Qeveria garanton 100% të principalit dhe mbulon direkt kostot e interesit. Nivelet e interesit mbulohen deri në 2.85% dhe maturimi është deri në 2 vjet me një periudhë pa pagesë 3-mujore mbi principalin. Linja e garancisë sovrane shtesë e pafinancuar prej 15 miliard lekë (0.9% e PBB) u aprovua në 15 Prill për të mundësuar huatë për kapitale pune dhe investime. Të gjitha kompanitë private që kishin paguar taksat dhe me kredi të shëndetshme para pandemisë kishin të drejtë për të përfituar. Qeveria garantonte vetëm 60% të principalit me maturim huaje deri në 5 vite me mbulim të nivelit të interest (5%), kufiri i huasë individuale (300 milion lekë), dhe 6 muaj periudhe pa pagesë me ripagesë ndaj principalit. <p>Totali: 1.7% of PBB</p>

Në kuadër të Programit të Përbashkët të Kombeve të Bashkuara “Përmirësimi i Ofrimit të Shërbimeve të Mbrojtjes Sociale në Nivel Vendor”, ILO në bashkëpunim me UNICEF dhe UN Women ka kryer një rishikim të sistemit të mbrojtjes sociale në Shqipëri, me qëllim identifikimin e boshllëqeve si dhe gjetjen e hapësirave për mbulimin dhe financimin e sistemit ekzistues, si dhe duke analizuar hapësirën fiskale për ndërtimin e një sistemi gjithëpërfshirës përfshirë edhe dyshemetë kombëtare të mbrojtjes sociale .

Raporti i tanishëm ofron një përmbledhje të sistemeve aktuale të mbrojtjes sociale kombëtare, si kontributive ashtu dhe ato jo-kontributive, dhe vlerëson tendencat dhe performancën e tyre të fundit në lidhje me strukturën dhe nivelin e shpenzimeve sociale, mbulimin dhe mjaftueshmërinë e përfitimeve, mbulimin e kontribuesve dhe qëndrueshmërinë financiare.

ilo.org/Budapest

Zyra Qëndrore e ILO për Europën Lindore dhe Qëndrore
14 Mozsár utca
H-1066 Budapest
Hungary